



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Zyra Kombëtare e Auditimit
Nacionalna Kancelarija Revizije
National Audit Office

RAPORTI I AUDITIMIT PËR PASQYRAT FINANCIARE VJETORE TË KOMUNËS SË PRISHTINËS PËR VITIN 2023

Raporti i nënshkruar nga
Vlora Spanca,
Auditore e Përgjithshme

Prishtinë, qershor 2024

PËRMBAJTJA E RAPORTIT

- 1 Opinioni i Auditimit
- 2 Gjetjet dhe rekomandimet
- 3 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit
- 4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Shtojca I: Letër konfirmimi

Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

1 Opinioni i Auditimit

Ne kemi përfunduar auditimin e pasqyrave financiare të Komunës së Prishtinës për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2023, në përputhje me Ligjin për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës dhe Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Auditimi është kryer për të na mundësuar të shprehim opinionin për pasqyrat financiare dhe konkluzionin për pajtueshmërinë me autoritetet.¹

Opinion i kualifikuar për pasqyrat financiare vjetore

Ne i kemi audituar pasqyrat financiare vjetore të Komunës së Prishtinës (Komuna e Prishtinës), të cilat përmbajnë pasqyrën e pranimeve dhe pagesave në para të gatshme, raportin e ekzekutimit të buxhetit si dhe shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare, përfshirë përmbledhjen e politikave të rëndësishme të kontabilitetit dhe raportet tjera², për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2023.

Sipas opinionit tonë, përveç ndikimit të çështjes/ve të përshkruara në paragrafin për Bazën për Opinion të Kualifikuar, Pasqyrat Financiare Vjetore të Komunës së Prishtinës, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik, sipas kontabilitetit të bazuar në para të gatshme.

Baza për Opinion të Kualifikuar

- A1 Detyrimet kontingjente në PVF ishin nënvlerësuar për vlerën 9,429,692€;
- B1 Komuna gjatë ekzekutimit të buxhetit, kishte realizuar pagesa në vlerë 4,335,532€ nga kategori ekonomike joadekuate;
- A2 Pagesa nga investimet kapitale në vlerë 219,571€, nuk ishte regjistruar në regjistrin e pasurive kapitale;
- A3 Dy fatura të papaguara të vitit 2023 në vlerë 26,959€, nuk ishin shpalosur në PVF.

Më gjerësisht shih nënkapitullin 2.1 Çështjet që ndikojnë në opinion të auditimit

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa e raportit 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat e tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA-ja është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinion.

Konkluzion për pajtueshmërinë

Ne kemi audituar nëse proceset dhe transaksionet përcjellëse janë në pajtueshmëri me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Sipas konkluzionit tonë, për shkak të rëndësisë së çështjes/ve të përshkruara në seksionin Baza për Konkluzion të pajtueshmërisë, transaksionet e kryera në procesin e ekzekutimit të buxhetit të Komunës së Prishtinës nuk kanë qenë në përputhje me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Baza për konkluzion

- A4 Në tetë (8) pagesa në vlerë totale prej 2,209,581€, janë bërë ndryshime në shumat e ndara buxhetore të projekteve kapitale pa aprovim të Kuvendit Komunal;
- C1 Në shtatë (7) kontrata publike kornizë me çmime për njësi, vlera e shpenzuar e një kategorie të caktuar, ka tejkaluar vlerën e lejuar për shpenzim sipas peshimit;
- A5 Në tetë (8) kontrata për punë, ka pasur rritje të sasive në pozicione, pa marrë aprovimet e duhura;
- A6 Në pesë (5) procedura të prokurimit, operatorët ekonomik të përzgjedhur si fitues, ishin të papërgjegjshëm;
- B2 Në pesë (5) raste në vlerë 260,838€, komuna kishte ndarë subvencione ndaj OJQ-ve duke mos aplikuar thirrjen publike;
- A7 Subvencioni në vlerë 30,000€ nuk ishte shpenzuar në përputhje me qëllimin e dhënë;
- C2 Mosevidentimi i numrave personal për 7,701 tatimpagues në databazën e tatimit në pronë;
- B3 Në gjashtë (6) raste në vlerë 442,777€, pagesat janë vonuar përtej afatit ligjor prej 30 ditësh;
- B4 Kontrata e mirëmbajtjes “Në Shtëpi” ishte lidhur për shërbime retroaktive;
- A8 Në 39 raste të pagesave në vlerë 2,644,505€, nuk ishin respektuar hapat e përcaktuara për procedim të pagesave sipas rregullave financiare lidhur me zotimin e mjeteve dhe nxjerrjen e urdhërblertes para pranimit të mallrave/punëve dhe faturës.

Më gjerësisht shih nënkapitullin 2.2 Çështjet që ndikojnë në konkluzionin e pajtueshmërisë

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa e raportit ‘Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare’. Në përputhje me ONISA-P10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për konkluzion.

Përgjegjësitë e Menaxhmentit dhe të organeve drejtuese/qeverisëse për pasqyrat financiare vjetore

Kryetar i Komunës është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të Pasqyrave Financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme. Po ashtu, Kryetar i Komunës është përgjegjës edhe për vendosjen e kontrolleve të brendshme, të cilat i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e Pasqyrave Financiare, pa keq deklarime materiale të shkaktuara, qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë përbushjen e kërkesave që burojnë nga Ligji nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë dhe Rregullorja nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizata Buxhetore.

Kryetar i Komunës është përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Komunës së Prishtinës.

Përgjegjësia e Menaxhmentit për Pajtueshmërinë

Menaxhmenti i Komunës së Prishtinës është gjithashtu përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare të Komunës së Prishtinës në përputhje me Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësinë dhe të gjitha rregullat dhe rregulloret e tjera të zbatueshme.³

Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV-ve

Objektivat tona janë të ofrojmë siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit dhe të hartojmë një raport të auditimit që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci se një auditim i kryer në përputhje me SNISA-t do të zbulojë çdo keq-deklarim material që mund të ekzistojë. Keq-deklarimet mund të vijnë nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose si tërësi, në mënyrë të arsyeshme pritet të ndikojnë në vendimet ekonomike të përdoruesve të marra në bazë të këtyre pasqyrave financiare.

Objektivi ynë është gjithashtu të shprehim një konkluzion të auditimit për pajtueshmërinë e autoriteteve përkatëse të Komunës së Prishtinës me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare, lidhur me subjektin e audituar.

Si pjesë e auditimit në përputhje me Ligjin për ZKA dhe SNISA-të, ne ushtrojmë gjykim dhe skepticism profesional gjatë gjithë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e keq-deklarimit material të pasqyrave financiare, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që i përgjigjen atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për opinionin. Rreziku i mos zbulimit të një keq-deklarimi material që rezulton nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontrolleve të brendshme.

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e mos-pajtueshmërisë me autoritetet, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që janë përgjegjëse ndaj atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për konkluzionin tonë për pajtueshmërinë me autoritetet. Rreziku i mos zbulimit të një rasti të mos pajtueshmërisë me autoritetet që vjen nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontrollit të brendshëm.
- Sigurohemi ta kuptojmë kontrollin e brendshëm relevant për auditimin, për t'i hartuar procedurat e auditimit që janë të përshtatshme, por jo me qëllim të shprehjes së një opinioni mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të Komunes së Prishtinës.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave të kontabilitetit të përdorura dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve të kontabilitetit dhe shpalosjet e ndërlydhura të bëra nga menaxhmenti.
- Vlerësojmë prezantimin e përgjithshëm, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, përfshirë shpalosjet, për t'u siguruar se pasqyrat financiare paraqesin transaksionet dhe ngjarjet themelore në mënyrë të drejtë dhe të saktë.

Ndër të tjera, ne komunikojmë me menaxhmentin dhe ata që janë përgjegjës për qeverisjen edhe në lidhje me fushëveprimin dhe kohën e planifikuar të auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi domethënëse në kontrollin e brendshëm që ne e identifikojmë gjatë auditimit.

Nga çështjet e komunikuar me menaxhmentin, ne përcaktojmë ato çështje që ishin më të rëndësishme në auditimin e Pasqyrave Financiare të periudhës aktuale dhe që cilësohen si çështje kyçe të auditimit. Raporti i auditimit publikohet në ueb faqen e ZKA-së, me përjashtim të informacioneve që klasifikohen si senzitive apo për shkak të ndalesave të tjera ligjore e administrative, në pajtim me legjislacionin në fuqi.

2 Gjetjet dhe rekomandimet⁴

Gjatë auditimit, kemi identifikuar fusha në të cilat nevojiten përmirësime në menaxhimin financiar dhe kontrollin, të cilat janë paraqitur më poshtë për shqyrtimin tuaj në formë të gjetjeve dhe rekomandimeve.

Cështjet më me fokus dhe që kanë ndikuar në opinionin financiar të auditimit janë ato që kanë të bëjnë me klasifikimin jo të duhur të shpenzimeve, paraqitjen jo të drejtë dhe jo të saktë të detyrimeve kontingjente, pasurive jofinanciare dhe detyrimeve të papaguara.

Kontrollet mbi të hyrat kanë nevojë të forcohen tek gjenerimi i informacioneve të sakta lidhur me të dhënat nga tatimi në pronë, vonesat në shqyrtimin e lejeve ndërtimore dhe mangësitë të shfrytëzimit i pronës publike. Fusha për përmirësim të mëtejshëm janë identifikuar tek menaxhimi jo i mirëfillitë kontratave publike, ndryshimet në shuma buxhetore pa aprovimet e duhura, mangësi në procesin e subvencionimit dhe në procesin e vlerësimit të ofertave gjatë procedurave të prokurimit. Kontrollet duhet të forcohen edhe tek hartimi i specifikave të kontratave për punë nga njësitë kërkuese. Ndërsa tek fusha e pasurisë, masa duhet të ndërmerren për funksionalizimin e e-pasurisë dhe kryerjen e procesit të inventarizimit sipas kërkesave të rregullores për pasuritë.

Gjetjet dhe rekomandimet kanë për qëllim të bëjnë korrigjimin e nevojshëm të informacionit financiar të paraqitur në pasqyrat financiare, duke përfshirë shpalosjet në formë të shënimeve shpjeguese dhe të përmirësojnë kontrollet e brendshme lidhur me raportimin financiar dhe pajtueshmërinë me autoritetet në lidhje me menaxhimin e fondeve të sektorit publik. Ne do t'i përcjellim (shqyrtojmë) këto rekomandime gjatë auditimit të vitit të ardhshëm.

Ky raport ka rezultuar me 22 rekomandime, prej tyre 11 janë rekomandime të reja, tetë (8) rekomandime të përsëritura dhe tri (3) rekomandime pjesërisht të përsëritura. Ne do t'i përcjellim (shqyrtojmë) këto rekomandime gjatë auditimit të vitit të ardhshëm.

Shuma e pagesave të realizuara nga Thesari, në bazë të vendimeve gjyqësore/përmbartimore për kontratën kolektive ishte 2,998,352€. Prej tyre, borxhi kryesor ishte 2,110,603€, ndërsa 887,749€ ishin shpenzime të interesit dhe procedurale të gjykatës/përmbartimi.

Derisa për statusin e rekomandimeve të vitit paraprak dhe nivelin e zbatimit të tyre, shih kapitullin 4.

2.1 Çështjet që ndikojnë në opinionin e auditimit

Çështja A1 - Nënvlërësimi i detyrimeve kontingjente

Gjetja

Bazuar në Rregulloren nr.01/2017 për Raportim Vjetor Financiar, neni 18, organizatat buxhetore në harmoni me LMFPP-në, raportojnë të gjitha detyrimet kontingjente.

Detyrimet kontingjente të prezantuara në pasqyrat vjetore financiare të komunës, nuk ishin prezantuar në mënyrë të saktë dhe të plotë. Ato ishin nënvlerësuar për 9,429,692€.

Kjo kishte ndodhur si rezultat i mosfunksionimit të kontrolleve në menaxhimin e regjistrin të detyrimeve kontingjente, ku si pasojë e volumit të madh të lëndëve, lëndët për të cilat nuk ishin zhvilluar seanca gjatë vitit, nuk ishin paraqitur në regjistrin e detyrimeve kontingjente.

Ndikimi Mosparaqitja e plotë e detyrimeve kontingjente në raportin vjetor financiar, ndikon në informacionin e pasaktë dhe të mangët të ofruar për palët e interesit. Kjo gjithashtu, ndikon në mosplanifikimin e duhur të buxhetit për të financuar detyrimet potenciale që mund të rezultojnë nga lëndët që janë në konteste gjyqësore.

Rekomandimi A1 Kryetari duhet të sigurojë forcimin e kontrolleve dhe mbikqyrjen, veçanërisht në rastet kur kemi një volum të madh të lëndëve, në menaxhimin e detyrimeve kontingjente, në mënyrë që informatat financiare për detyrimet kontingjente të shpalosen në mënyrë të saktë dhe të plotë.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja B1 - Keqklasifikimi i shpenzimeve në kategoritë ekonomike

Gjetja Sipas nenit 18 pikës 3 të Rregullës Financiare Nr. 01/2013 Shpenzimi i parave publike, shpenzimet duhet të kenë kodet adekuate, të përcaktuara me planin kontabël. Po ashtu me planin kontabël të Thesarit janë përcaktuar kodet dhe kategoritë përkatëse të shpenzimeve që OB-të duhet të aplikojnë.

Në bazë të pagesave të testuara, kemi vërejtur se janë bërë pagesa nga kodet joadekuate, në vlerë 4,335,532€ si në vijim:

- Nga kategoria e investimeve kapitale, janë bërë pagesa që i takojnë mallrave dhe shërbimeve, në (tetë) 8 raste në vlerë prej 1,217,757€;
- Nga kategoria e mallrave dhe shërbimeve, janë bërë pagesa që i takojnë subvencioneve dhe transfereve, në 13 raste në vlerë 1,541,837€, si dhe investimeve kapitale, në tri raste në vlerë 800,000€; si dhe
- Me rastin e ekzekutimit të pagesave nga thesari për obligimet e kontrates kolektive, kemi vërejtur keqklasifikime të shpenzimeve nëpër kategori ekonomike në vlerë 775,938€. Nga kjo vlerë, thesari kishte paguar sipas vendimit përmbarimor të gjykatës për paga jubilarë dhe shujta për arsimtarë nga kategoria e mallrave dhe shërbimeve 666,354€ dhe nga kategoria e investimeve kapitale 109,584€.

Klasifikimi joadekuat i shpenzimeve ishte rezultat i mosfunksionimit të mirë të kontrolleve të brendshme në planifikimin e buxhetit dhe realizimin e pagesave nga kategoritë adekuate.

Ndikimi Pagesat e kryera nga kategoritë joadekuate të shpenzimeve ndikojnë në raportimin financiar jo të drejtë, si dhe në mbivlerësimin/nënvlerësimin e kategorive të shpenzimeve.

Rekomandimi B1 Kryetari duhet të sigurojë se shpenzimet planifikohen dhe realizohen sipas kategorive ekonomike adekuate, në përputhje me planin kontabël, për të mundësuar raportimin e drejtë të tyre në PVF.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja A2 - Mosregjistrimi i pagesës së investimeve kapitale në regjistrin e pasurive**Gjetja**

Bazuar në Rregullores MF nr. 02/2013 Për Menaxhimin e Pasurisë jo Financiare në Organizatat Buxhetore, neni 6 Regjistri I pasurive jo financiare paragrafi 3, Pasuria kapitale duhet të regjistrohet në SIMFK, ndërsa pasuria jo kapitale dhe stoqet duhet të regjistrohet në sistemin “e-pasuria”.

Pasuritë kapitale të prezantuara në raportin vjetor financiar, ishin nënvlerësuar për vlerën prej 219,571€, për shkak të mosregjistrimit të pagesës nga kontrata “Mirëmbajtja e rregullt dhe renovimi urgjent i ndërtesave edukativo arsimore“ që kishte të bënte me renovimin e shkollës Hoxhë Kadri Prishtina. Investimet kanë të bëjnë me rregullimin e hapësirave të brendshme dhe të jashtme në objekte shkollore si furnizimi, përpunimi, montimi dhe rregullimi i interierit i përbërë nga konstruksionet e drurit, ndërrimi dhe vendosja e dyerve të reja nga alumini dhe druri, ngjyrosja me ngjyrë të fasadës për sipërfaqen e jashtme, ndërrimi i pllakave të dyshemesë dhe banjove, ku këto blerje sipas natyrës i përkasin kategorisë së investimeve kapitale dhe është dashur të regjistrohen në regjistrin kontabel të pasurive mbi 1000€.

Kjo kishte ndodhur për shkak që zyrtari i pasurisë e kishte vlerësuar gabimisht se lënda ka të bëjë me mirëmbajtje të pasurive.

Pas dërgimit të draft raportit në entitet, zyrtari i pasurisë ka marrë veprime duke e regjistruar pagesën në regjistrin e pasurive në SIMFK.

Ndikimi

Mosregjistrimi i pasurive kapitale ndikon që vlera e pasurive jofinanciare të paraqitura në raportin vjetor financiar të jetë e nënvlerësuar.

Rekomandimi A2

Kryetari duhet të sigurojë që pasuritë kapitale regjistrohen dhe raportohen në mënyrë të saktë dhe të plotë, në përputhje me kërkesat ligjore.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)**Çështja A3 - Mosprezantimi i detyrimeve të papaguara në PVF****Gjetja**

Sipas Rregullores së MF. Nr. 01/2017 për raportim vjetor financiar nga organizatat buxhetore, neni 17, pika 3 kërkon që organizatat buxhetore duhet të raportojnë të gjitha detyrimet (faturat) të krijuara deri më 31 dhjetor të vitit raportues.

Gjatë testimit të shpalosjeve për detyrimet e papaguara, ne kemi vërejtur se dy fatura në vlerë 26,959€ të cilat i takojnë vitit 2023, nuk ishin paraqitur apo shpalosur në PVF si detyrime të papaguara.

Kjo kishte ndodhur si rezultat i mungesës së kontrolleve të brendshme me rastin e prezantimit apo shpalosjes së detyrimeve në PVF.

Ndikimi

Mosparaqitja e saktë e vlerës së detyrimeve të papaguara në PVF ndikon në nënvlerësimin dhe prezantimin e informatave jo të sakta për shfrytëzuesit e PVF-ve.

Rekomandimi A3 Kryetari duhet të sigurojë kontrolle efektive në regjistrimin dhe paraqitjen e saktë të vlerës së detyrimeve të papaguara, sipas kërkesës së rregullore për raportim financiar, në mënyrë që të mundësohet raportim i saktë i tyre në PVF.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.2 Çështjet që ndikojnë në konkluzionin e pajtueshmërisë

Çështja A4 - Ndryshimet në shumat e ndara buxhetore të projekteve kapitale pa aprovim të kuvendit komunal

Gjetja Bazuar në nenin 16 të ligjit të buxhetit, paragrafi 11, ndryshimet në shumat e ndara buxhetore për projektet ekzistuese si rezultat i transfereve dhe/ose rialokimeve, të prezantuara në tabelën 4.2., duke përfshirë edhe të hyrat vetanake të bartura, si dhe të regjistruara në SIMFK, duhet të aprovohen paraprakisht nga Kuvendi Komunal.

Në tetë* (8) pagesa të investimeve kapitale, në vlerë totale prej 2,209,581€, fondet janë marrë nga projekte tjera të aprovuara në ligjin e buxhetit. Në katër (4) prej tyre në vlerë 757,339€, fondet janë paguar me urdhëresë të kryetarit të komunës sipas kërkesës së drejtorisë përkatëse. Megjithatë, për këto ndryshime në shumat e ndara buxhetore, nuk ishin marrë aprovimet nga Kuvendi Komunal.

Kjo vjen si rezultat i mospërgjegjësisë së menaxhmentit të komunës për të zbatuar kërkesat e ligjit të buxhetit lidhur me ndryshimet buxhetore.

Ndikimi Ndryshimet në shumat buxhetore pa aprovim të Kuvendit Komunal, mund të reduktojnë transparencën dhe llogaridhënien në vendimet e marra rreth shfrytëzimit të fondeve publike. Këto, po ashtu mund të kenë ndikim negativ në implementimin e projekteve ekzistuese duke pamundësuar financimin e mjaftueshëm për to.

Rekomandimi A4 Kryetari duhet të sigurojë, se për çdo ndryshim në shumat buxhetore të projekteve të aprovuara në ligjin e buxhetit, të marrë paraprakisht aprovimin nga Kuvendi Komunal.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja C1 - Realizimi i sasive të kontratave publike kornizë, në mos përputhje me peshët e përcaktuara në dosje të tenderit

Gjetja Bazuar në Rregulloren nr.001/2022 për prokurimin publik, neni 17.35 Kurdo që Autoriteti kontraktues nuk din sasi të indikative, kontratat me çmime për njësi, AK duhet të përcaktoj peshët në bazë të rëndësisë së secilës "kategori të shërbimeve" në mënyrë që AK të përcaktoj se cila është oferta me çmim më të ulët në baze të poentimit. Si rrjedhojë, peshimi i artikujve duhet bërë bazuar në peshën dhe rëndësinë e kategorisë përkatëse, që do të thotë se sasia e realizuar (shpenzuar) nuk mund dhe nuk duhet të ndryshoj nga raportet sipas peshës së dhënë në Dosjen e Tenderit. Menaxheri i kontratës mbetet përgjegjës që të dëshmojë në mënyrë të qartë se sasia e porositur dhe shpenzuar është në harmoni me peshën e dhënë dhe me nevojat reale të AK.

Në shtatë (7) kontrata publike kornizë me çmime për njësi, vlera e shpenzuar e një kategorie të caktuar, ka tejkaluar vlerën e lejuar për shpenzim sipas peshimit. Bëhet fjalë për kontratat si në vijim:

- Në kontratën "Ndërtimi i semaforëve, modernizimi, ndërtimi i paneleve ndricuese dhe matësve të shpejtësisë" me vlerë të

parashikuar 450,000€, kategoria B e specifikave është peshuar me 30% të kontratës apo lejim të shpenzimit deri në vlerë 135,000€, ndërsa ishte tejkaluar duke u realizuar në vlerë 274,927€ apo 60% e vlerës së kontratës;

- Në kontratën “Ndërtimi dhe sanimi i kanalizimeve” në vlerë 500,000€, në dosjen e tenderit pozicionit që më së shumti i ishte dhënë peshë në bazë të rëndësisë ishte pozicioni “Punët Montuese” me 30%, ndërsa ky pozicion ka pasur më së paku realizim në kontratë, me vetëm 7% të realizimit. Më tutje, tek tri pozicione tjera ka tejkalim të realizimit, sikurse: punët përgatitore ishin peshuar me 12.5% ndërsa janë realizuar 20%, punët e dheut janë planifikuar 12.5% e kontratës, ndërsa janë realizuar 44%, si dhe testimi i rjetit është peshuar me 4% ndërsa është realizuar 13%;
- Në kontratën “Intervenime infrastrukturore në Komunën e Prishtinës” Lot 1 në vlerë 400,000€, në pozicionin e riparimeve, peshimi ishte 39.5%, apo lejim i shpenzimit deri në vlerë 158,000€, ndërkaq realizimi në këtë kategori ishte bërë 178,739€ apo deri në 45% të kontratës. Poashtu, në pozicionin e tamponit, ku peshimit ishte vendosur 11.5%, apo deri në 46,000€, realizimi ishte bërë 71,751€ apo 18% e kontratës;
- Në kontratën “Intervenime infrastrukturore në Komunën e Prishtinës” Lot 3, në vlerë 600,000€, tek pozicioni i katërt “Punët e tamponit, riparimeve me pllaka te betonit”, peshimi në bazë të rëndësisë ishte vendosur 11,5% apo deri në 69,000€, ndërsa realizimi në këtë kategori ishte 39.4%, apo 236,668€;
- Në kontratën “Zgjerimi dhe modernizimi i rjetit për ndriçim publik Lot 1” me vlerë të parashikuar 600,000€, kategoria A e peshuar me 70%, e cila vlerën e lejuar të shpenzimit e kishte 420,000€, ishte shpenzuar në vlerë 502,721€, apo 84% e vlerës së kontratës;
- Në kontratën “Plani i mobilitetit-shenjezimi i shtigjeve te bicikletave” me vlerë të parashikuar 495,000€, tek kategoria e A e cila peshën e kishte 50% të kontratës, apo deri në 247,500€, realizimi ishte 284,645€, apo 57% e kontratës; si dhe
- Te kontrata “Sinjalizimi horizontal dhe vertikal Lot 1” në vlerë 450,000€, tek kategoria e parë me peshim 80%, ku vlera totale e lejuar e shpenzimit ishte 360,000€, shpenzimi i realizuar ishte 403,822€ apo 90% e kontratës.

Këto tejkalime kishin ndodhur si pasojë e planifikimit jo të mirë të nevojave dhe përcaktimit jo të duhur të peshimit të kategorive në bazë të rëndësisë së punëve/shërbimeve në dosjen e tenderit.

Ndikimi

Tejkalimi i shpenzimit të sasive të lejuara sipas peshës që iu është caktuar në dosjen e tenderit dhe në kontratë, ndikon në mungesë të transparencës në vendimmarrjen për zgjedhjen e ofertës me çmimin më të ulët. Kjo poashtu, mund të ndikojë në rritjen e shpenzimeve të planifikuara buxhetore.

Rekomandimi C1

Kryetari i Komunës duhet të sigurojë përmes njësive kërkuese, që gjatë përgatitjes së kërkesave dhe dosjeve të tenderit për kontratat publike kornizë sipas peshimit, të luaj një rol aktiv në përcaktimin e nevojave reale të komunës, në mënyrë që këto kontrata të realizohen në pajtueshmëri të plotë me peshët e përcaktuara në dosjen e tenderit.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja A5 - Ndryshimet në kushtet e kontratës pa aprovimet e duhura**Gjetja**

Bazuar në Rregulloren nr.001/2022 për prokurimin publik, neni 71.1 Ndryshimi i kontratës i referohet një ndryshimi në termat dhe kushtet e një kontratë të shpërblyer. Ndryshimi i kontratës iniciohet nga Menaxheri i kontratës. Në rast të kontratave për punë nevojitet aprovimi paraprak i projektuesit. Aty ku ndryshohet kontrata me qëllim të ndryshimit të termave dhe kushteve fillestare, ndryshimi i kontratës do të përgatitet nga departamenti i prokurimit. Ndryshimi i kontratës nuk do t'i lëshohet Operatorit ekonomik para marrjes së aprovimit nga ZKA.

Ne kemi vërejtur se në tetë (8) kontrata për punë, ka pasur rritje në sasi të realizuara të pozicioneve të caktuara, por pa e ndryshuar vlerën totale të kontratës, të autorizuara nga menaxherët e kontratave. Për këto ndryshime, nuk kishte amendamentim të kontratës, nuk ishte kërkuar aprovimi zyrtar nga projektuesi dhe as nga Kryetari i Komunës.

Ndryshimet në sasi të kontraktuara kishin ndodhur në kontratat si në vijim:

- Në kontratën "Vazhdimi i punimeve në shkollën Nëna Terezë" në vlerë 412,240€, kishte rritje të sasive të realizuara në katër pozicione të kontratës në vlerë 13,678€, apo deri në 140% rritje të sasive në pozicionet e kontraktuara;
- Në kontratën "Ndërtimi i tribunës lindore për stadiumin 2 Korriku" në vlerë 108,381€, kishte rritje të sasive të realizuara në tri pozicione në vlerë 9,215€, apo deri në 79% rritje të sasive në pozicionet e kontraktuara;
- Në kontratën "Rikonstruimi i rrugës Malush Kosova" në vlerë 386,259€, kishte rritje të sasive të realizuara në dy pozicione, ku rritja ishte në vlerë 7,574€, apo deri në 233% të sasisë për pozicionin e kontraktuar;
- Në kontratën "Renovimi i pushimores për të moshuarit në Istog" në vlerë 61,693€, rritja e sasive në pozicione ishte në vlerë 4,800€, apo deri në 174% të sasisë për pozicionin e kontraktuar;
- Në kontratën "Ndërtimi i rrugës Shkendija në Zllatar" në vlerë 1,233,392€, kishte rritje të sasisë në nëntë pozicione me vlerë gjithsej 16,803€, apo deri në 123% të sasisë për pozicionin e kontraktuar;
- Në kontratën "Ndërtimi i zveshtores dhe tribunës për stadiumin KF Flamurtari", në vlerë 177,684€, kishte rritje të sasisë në tetë pozicione të kontraktuara, në vlerë 34,442€, apo deri në 528% të sasisë për pozicionin e kontraktuar;
- Në kontratën "Regjerenimi i rrugës Mehmet Kaçurri" në vlerë 371,856€ kishte rritje të sasisë në katër pozicione në vlerë 4,289€, apo deri në 1,150% rritje të sasive në pozicionet e kontraktuara;

Këto kishin ndodhur si rezultat i mosfunksionimit të kontrolleve në menaxhimin e kontratave, si dhe mos planifikimit të mirëfilltë të projekteve.

Ndikimi

Ndryshimi i paramasës së kontraktuar, në mungesë të aprovimeve të duhura dhe dëshmime se janë bërë analiza specifike për këto ndryshime, rrezikon që realizimi i punëve të mos jetë konform kërkesave të projektit dhe krijon mundësinë për manipulime me pozicionet dhe paramasat e tenderit fillestar. Kjo rrjedhimisht mund të shpie në tejkalimin e kontratës.

Rekomandimi A5 Kryetari i Komunës, duhet të forcojë llogaridhënien lidhur me menaxhimin e projekteve kapitale, duke siguruar se për cdo ndryshim në termat dhe kushtet e kontratës, të zbatohen procedurat për marrjen e aprovimeve të duhura sipas rregullave të prokurimit/aplikueshme dhe amandamentimin e kontratës në pajtim me ndryshimet e bëra.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja A6 - Përzgjedhja e operatorëve ekonomik të papërgjegjshëm, gjatë vlerësimit të ofertave në procedurat e prokurimit

Gjetja Sipas nenit 59.4 të LPP-së, autoriteti kontraktues do të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në dosjen e tenderit dhe në njoftimin për kontratë.

Në pesë (5) procedura të prokurimit, kemi vërejtur mangësitë në procesin e vlerësimit, si në vijim:

- Në dosjen e tenderit për projektin “Ndërtimi i rrugës Abedin Dino - Kolovice, faza e parë ritender” kontrata e nënshkruar në vlerë 676,087€, tek kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale është kërkuar që OE të sigurojë : pajisjet/mjetet e punës: Kamion me kapacitet mbi 20 m3 kiper 6 Copë. OE i shpallur i përgjegjshëm/fitues në këtë tender, kishte siguruar vetëm një kamion me kapacitetin e kërkuar, ndërsa pesë kamionë tjerë janë nën kapacitetin e kërkuar në dosjen e tenderit;

Më tutje, ishte kërkuar të sigurohet: Raporti i vlerësimit të riskut në vendet e punës, nga një kompani e licencuar nga MPMS, për Siguri dhe shëndet në punë - Kopja e raportit të vlerësimit të riskut në vendet e punës;

OE fitues lidhur me këtë kërkesë kishte siguruar një raport të vlerësimit të riskut, të cilit i kishte kaluar validiteti pesë muaj para datës së njoftimit për kontratë.

Në këtë tender, oferta fituese ishte oferta më e shtrenjtë nga ofertat e pranuar, pasi ofertat tjera ishin vlerësuar të papërgjegjshme.

- Në dosjen e tenderit për projektin “Ndërtimi i mbikalimit tek stacioni i trenit”, kontrata e nënshkruar në vlerë 548,845€, në dosjen e tenderit tek kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale, është kërkuar që OE të sigurojë: pajisje/mjetet e punës: Ekskavator me goma minimum 19 ton si dhe Eskavator me goma minimum 17 ton.

OE i shpallur i përgjegjshëm/fitues, për këtë kërkesë kishte siguruar dy fatura të blerjes së pajisjeve, dhe asnjë dokument që vërteton kapacitetin e kërkuar të këtyre mjeteve të punës.

- Sipas interpretimit të KRPP-së nr. 29 datë 22.06.2023, në rast të kontratave për furnizime, kur AK kërkon dëshmi Certifikata të hartuara nga institutet zyrtare për kontrollimin e cilësisë që vërtetojnë përshtatshmërinë e produkteve që qartazi mund të identifikohen duke u bazuar në specifikimet dhe standardet përkatëse, atëherë një dëshmi e tillë mjafton të silltet nga anëtari i grupit i cili do të kryej

furnizimin, në mënyrë që të konsiderohet se kërkesa është përmbush nga grupi si tërësi. Pavarësisht nga kjo, në rast se të gjithë anëtarët e grupit marrin pjesë në ekzekutimin e kontratës duke liferuar furnizime të prodhuara nga vetë ato, atëherë të gjithë anëtarët e grupit duhet të jenë të pajisur me certifikata të tilla, në mënyrë që AK të sigurohet se produktet e furnizuara janë të cilësisë sipas standardeve përkatëse të specifikuara në dokumentet e tenderit.

Në dosjen e tenderit për kontratën “Vendosja e kamerave në Kryeqytet” me vlerë totale indikative 1,350,000€, tek kërkesat e përshtatshmërisë profesionale ishte kërkuar që OE duhet të ofrojë certifikatat a) ISO 9001 2015; b) ISO 14001 2015; c) ISO 45001 2018.

Ne kemi vërejtur se OE fitues, në listën e certifikatave ISO të ofruara kishte siguruar vetëm ato të partnerit të dytë të koncorziumit, por jo edhe të partnerit të parë. Për këtë çështje, Komisioni përkatës gjatë vlerësimit të tenderit ka kërkuar sqarime shtesë. Ne kemi vërejtur se ofrimi i informacionit në lidhje me dokumentet e ofruara e ka ndryshuar gjendjen ekzistuese të dokumentacionit të kërkuar në dosje të tenderit, pasi që datat e lëshimit të certifikatave ishin gjatë kohës së vlerësimit të tenderit dhe Komisioni i ka marrë si të mirëqena, gjë bie ndesh me nenin 38 të Rregullores së prokurimit publik i cili thekson se gjatë sqarimit të tenderit, AK mund të kërkoj sqarime shtesë nga OE, mirëpo duhet të prezantojnë prova të mjaftueshme që në mënyrë të arsyeshme pasqyrojnë gjendjen ekzistuese para datës së publikimit të Njoftimit për kontrate.

- Në dosjen e tenderit për kontratën “Mirëmbajtja verore e rrugëve dhe trotuareve Lot 7” me vlerë indikative prej 393,189€, tek neni 13.3 theksohet se ndonjë tender që nuk është shoqëruar me një sigurim të përgjegjshëm të tenderit, tenderi do të refuzohet si tender i papërgjegjshëm dhe neni 13.4 thekson se forma e sigurisë së tenderit është e specifikuar në Aneksin 4 të kësaj dosje të tenderit. Gjatë ekzaminimit të ofertës së fituesit, kemi vërejtur që siguria e tenderit e dorëzuar në vlerë 8,600€ nuk ishte e përgjegjshme, pasi që kushtet për të cilat kompania e sigurimit është zotuar të paguajë në rast se operatori ekonomik ka bërë gabime nuk përkojnë me kushtet e përcaktuara sipas formës së sigurisë së tenderit të kërkuar në dosje të tenderit si: refuzimi i tenderuesit apo dështimi të plotësojë që të depozitojë sigurinë e ekzekutimit të specifikuar në Dosjen e Tenderit; plotësimi i të gjitha kushteve që i paraprijnë nënshkrimit të kontratës në fjalë siç është përcaktuar në Dosjen e Tenderit; apo lidhja e kontratës që u përshtatet afateve dhe kushteve të saktësuara në dosjen e tenderit.
- Në dosjen e tenderit për kontratën “Master plani për rigjenerimin e lagjes Kodra e Trimave” në vlerë 265,600€, tek kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale është kërkuar që të sigurohen dëshmitë si: CV, Diploma, Kontrata e punës me punëdhënësin ose marrëveshja mbi angazhimin për këtë projekt për arkitekt - Master i arkitekturës, minimum 3 vite përvojë pune. OE fitues nuk kishte bashkangjitur kontratën e punës apo marrëveshjen e angazhimit për inxhinierin e arkitekturës dhe komisioni i vlerësimit nuk kishte kërkuar sqarime shtesë nga OE.

Këto mangësi kishin ndodhur si pasojë e vlerësimit jokorrekt apo mos

kompetencës së komisioneve të vlerësimit, për t'i vlerësuar me kujdes ofertat dhe për t'i analizuar dëshmitë e ofruara në raport me kriteret e përcaktuara në dosje të tenderit. Poashtu për raste të caktuara, mos aplikimi i qartë i specifikave që duhet t'i plotësojnë anëtarët e grupit duke përcaktuar dëshmitë që duhet të sillen nga secili anëtar i grupit së bashku me tenderin e tyre.

- Ndikimi** Përzgjedhja e operatorëve ekonomik fitues të cilët nuk i plotësojnë në tërësi kërkesat në dosjen e tenderit, rrezikon cilësinë e realizimit të kontratës, si dhe besueshmërinë në procesin e prokurimit. Mungesa e sigurisë së tenderit sipas formës së kërkuar ndikon në pamundësinë e tërheqjes së sigurisë së tenderit nga Komuna në rast se operatori nuk iu përmbahet mbulesave të parapara në dosje të tenderit.
- Rekomandimi A6** Kryetari duhet të sigurojë forcimin e kontrolleve në fushën e prokurimit, në mënyrë që vlerësimi i ofertave të bëhet në pajtueshmëri të plotë me kërkesat e vendosura në dosjet e tenderit dhe në pajtueshmëri me kërkesat ligjore. Po ashtu, përmes zyrtarëve përgjegjës të sigurojë se anëtarët e komisioneve i kuptojnë detyrat dhe përgjegjësitë e tyre në angazhimet përkatëse, dhe në rast të gabimeve eventuale këto të evidentohen nga zyrtarët e prokurimit para nënshkrimit të raportit të vlerësimit.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja B2 - Subvencionimi i OJQ-ve pa thirrje publike

- Gjetja** Sipas nenit 2.1 të Rregullores MF-nr. 04/2017 - Mbi kriteret, standardet e financimit publik të Organizatave Jo Qeveritare (OJQ) parashihet që, financimi i projekteve dhe programeve të OJQ-ve bëhet sipas një thirrje publike, dhe të cilat i plotësojnë kriteret e Rregullores.

Në pesë (5) raste në vlerë 260,838€, komuna kishte ndarë subvencione ndaj OJQ-ve duke mos aplikuar thirrjen publike, por vetëm me vendim të Kuvendit Komunal. Këto subvencione kishin të bëjnë me fushën e sportit, sikurse përkrahjen e pjesëmarrjes në gara sportive, si dhe me projekte tjera që ndërlidhen me aktivitetet në shkollë dhe me nxënësit. Përveç kësaj, në tri raste, marrëveshjet me OJQ ishin lidhur pas pagesës së mjeteve.

Kjo kishte ndodhur për shkak të mosfunksionimit të kontrolleve të brendshme dhe mungesës së përgjegjësisë për zbatimin e kërkesave ligjore lidhur me subvencionimin e OJQ-ve.

- Ndikimi** Subvencionimi i OJQ-ve vetëm me vendim të Kuvendit Komunal, pa bërë thirrje publike, përjashton konkurrencën, transparencën si dhe ndikon në trajtimin jo të barabartë të OJQ-ve. Përderisa, mos aplikimi me kohë i marrëveshjeve mes përfituesit dhe komunës, ndikon që përfituesit të mos jenë të përgjegjshëm në përmbushjen e detyrimeve që përcaktohen në marrëveshje.

- Rekomandimi B2** Kryetari duhet të sigurojë se me rastin e mbështetjes financiare ndaj OJQ-ve, të aplikohen thirrjet publike sipas kërkesave të rregullores në fuqi. Gjithashtu, të sigurohet se nënshkrimi i marrëveshjes mes komunës dhe përfituesit, të bëhet para pagesës së mjeteve.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)**Çështja A7 - Shfrytëzimi i subvencionit jo në përputhje me qëllimin e dhënë**

Gjetja Sipas nenit 32.1 të Rregullores së Komunës, përfituesit e subvencioneve obligohen që pas marrjes së subvencionit të dorëzojnë në Komunë raportin me të gjitha shpenzimet financiare, ashtu siç janë kërkuar me projektpropozim.

OJQ përfituese në kategorinë e sportit për projektin për "Mbështetje financiare për mbarëvajtje të garave brenda dhe jashtë vendit" në vlerë 30,000€, kishte siguruar raportin narrativ dhe financiar për shpenzimin e fondeve të përfituara. Megjithatë, këto fonde ishin përdorur nga OJQ-ja për pagesën e borxheve të saj të vitit 2022 dhe jo për qëllimin për të cilin ishte subvencionuar.

Kjo kishte ndodhur për shkak të mungesës së kontrolleve në fushën e monitorimit të subvencioneve.

Ndikimi Shfrytëzimi i subvencioneve nga përfituesit jo në përputhje me qëllimin e dhënë, rezulton me vlerë të dobët të parasë së shpenzuar nga komuna.

Rekomandimi A7 Kryetari duhet të sigurojë forcimin e kontrolleve në fushën e dhënies dhe monitorimit të subvencioneve, në mënyrë që fondet e dhëna nga komuna të shfrytëzohen vetëm për qëllimet e subvencionuara. Nëse përfituesit nuk arrijnë të arsyetojnë shfrytëzimin e fondeve në përputhje me qëllimin e dhënë, të merren masa për kthimin e fondeve nga përfituesit.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)**Çështja C2 - Mangësi në databazën e tatimit në pronë**

Gjetja Ligji nr. 06/L-005 për Tatimin në Pronën e Paluajtshme, neni 11.1 përcakton se, personi fizik i cili vendos se njësi e objektit shërben si vendbanim parësor (për të cilën e deklaron në Komunë), i lejohe zbritja prej 15,000€ nga vlera e vlerësuar e njësisë së objektit.

Po ashtu, neni 7 pika 1.1 e Udhëzimit Administrativ 03/2011 për mbledhjen dhe regjistrimin e informatave mbi pronën dhe tatimpaguesit thekson se të dhënat e tatimpaguesit duhet të përfshijnë numrin personal identifikues (tatimpagues fizik).

Bazuar në databazën e tatimit në pronë, për 7,701 tatimpagues nuk ishte evidentuar numri personal. Nga konfirmimet e departamentit të tatimit në pronë në Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve (MFPT), për 20 tatimpagues pa numra personal ishte zbatuar zbritja prej 15,000€ nga vlera e vlerësuar e njësisë së objektit.

Kjo kishte ndodhur për shkak të mosgjenerimit të raporteve të sakta nga sistemi i tatimit në pronë, si dhe mungesës së veprimeve të mjaftueshme lidhur me identifikimin dhe zgjidhjen e këtyre mangësive, nga ana e departamentit të tatimit në pronë komunal dhe atij të MFPT-së për të ardhur tek përllogaritjet e sakta të zbritjeve të lejuara për tatimpaguesit.

- Ndikimi** Mungesa e informacioneve të sakta në databazën e tatimit në pronë, rezulton me përllogaritje të pasakta të zbritjeve për tatimin në pronë.
- Rekomandimi C2** Kryetari duhet të sigurojë bashkëpunim dhe komunikim më të mirë ndërmjet Departamentit të Tatimit në Pronë Komunal dhe MFPT-së, në mënyrë që të eliminohen gabimet e mundshme në të dhënat për tatimin e vlerësuar, apo ndonjë gabim tjetër eventual.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja B3 - Vonesat në pagesën e faturave dhe kosto shtesë për komunën për shkak të pagesave përmes vendimeve gjyqësore/ përmbarimore

- Gjetja** Sipas nenit 39 të LMFP-së, përcaktohet se ZKF i Organizatës Buxhetore është përgjegjës për të siguruar që çdo faturë e vlefshme dhe kërkesë për pagim për mallra dhe shërbimet e furnizuara dhe/ ose punët e realizuara për OB-në të paguhen brenda 30 ditëve kalendrike pas pranimit të faturës ose kërkesës për pagim. Ndërsa sipas nenit 40 të LMFP, fatura mund të ekzekutohet direkt nga Thesari pas marrjes së urdhrit të prerë nga gjykata/ përmbaruesi.
- Komuna në vitin 2023 kishte paguar 476,733€, në emër të kamatave dhe procedurave përmbarimore, si pasojë e pagesave me vendime gjyqësore. Në total, pagesat përfshirë borxhin dhe kamatat ishin 1,758,900€, ku për mallra dhe shërbime janë paguar 380,240€, dhe investime kapitale 1,378,660€
- Poashtu, në gjashtë (6) pagesa të testuara të investimeve kapitale në vlerë totale prej 442,777€, kemi vërejtur se faturat ishin vonuar për pagesë, përtej afatit ligjor prej 30 ditësh.
- Kjo ka ndodhur për shkak të kontrolleve joadekuate në ekzekutimin e pagesave dhe menaxhim të kontratave publike, mungesës së fondeve financiare pasi disa kontrata janë lidhur pa fonde të mjaftueshme dhe vonesave në kompletim të lëndëve.

- Ndikimi** Vonesat në pagesën e faturave, dhe si rrjedhojë pagesat e realizuara përmes vendimeve gjyqësore, vështirësojnë realizimin e buxhetit sipas planifikimeve, si dhe shkaktojnë kosto shtesë në buxhetin e Komunës.
- Rekomandimi B3** Kryetari duhet të forcojë kontrollet në menaxhimin e faturave, duke siguruar se pagesat bëhen brenda afatit të përcaktuar ligjor.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja B4 - Kontrata e mirëmbajtjes "Në Shtëpi" ishte lidhur për shërbime retroaktive

- Gjetja** Sipas kushteve të kontratës "Në shtëpi" e lidhur në mes Komunës dhe Ndërmarrjes Lokale Publike "Hortikultura" e datës 19.10.2022 janë paraparë kushtet rreth mirëmbajtjes dhe çmimet për shërbime.
- Përkundër përfundimit të kontratës me datë 31.12.2022, komuna kishte vazhduar të pranojë shërbime për muajt janar-mars dhe kryerjen e punëve nga NLP. Këto shërbime dhe punë janë paguar sipas kontratës së re, të lidhur më datë 03.04.2023 me një vlerë totale të pagesave prej 289,157€.

Sipas analizës për dy pozicione, kemi vërejtur se një pozicion ka qenë i ri nga kontrata paraprake dhe vlera e paguar ka qenë 9,600€, ndërsa për një pozicion tjetër është paguar më tepër për 1,601€ se sa çmimi në kontratën paraprake. Nuk kishte ndonjë dëshmi se si kishte ardhur deri te negociimi i çmimeve të reja dhe një praktike e tillë e pagesës së punëve/shërbimeve në mënyrë retroaktive nuk është përcaktuar në kontratë.

Kjo kishte ndodhur për shkak të mungesës së kontrolleve adekuate të zhvillimit të procedurave për lidhjen e kontratës së re para skadimit të kontratës së mëparshme.

Ndikimi Pagesat e realizuara në mënyrë retroaktive për shërbimet sipas kontratës së re janë pagesa të parregullta dhe rrezikojnë që Komuna të paguaj më tepër për shërbime të njëjta duke dëmtuar buxhetin e komunës.

Rekomandimi B4 Kryetari duhet të sigurojë se kontrata lidhen në kohën e duhur, faturimi dhe pranimi i punëve si dhe pagesa për këto punë të bëhen sipas çmimeve të kontraktuara për periudhën përkatëse dhe jo në mënyrë retroaktive.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja A8 - Mosrespektimi i hapave për procedimin e pagesave

Gjetja Sipas Rregullës financiare nr. 01/2013 për shpenzimin e parasë publike, neni 22, janë përcaktuar hapat për procedimin e pagesave, ku fillimisht bëhet kërkesa për blerje, lëshohet urdhërblerja, bëhet pranimi i mallit/shërbimit, pastaj operatori ekonomik sjellë faturën për pagesë.

Në 39 raste të pagesave në vlerë 2,644,505€, nuk ishin respektuar hapat e përcaktuara për procedim të pagesave, pasi që urdhërblerjet, zotimet dhe raportet e pranimi të menaxherëve ishin hartuar dhe nënshkruar pas pranimi të faturës.

Kjo dukuri ka ndodhur si rezultat i kontrolleve joefektive, për faktin që nuk janë zbatuar procedurat ligjore për shpenzimin e parasë publike nga ana e zyrtarëve përgjegjës.

Ndikimi Mosaplikimi i procedurave të duhura të kontrollit gjatë procesit të pagesave, mund të ndikojë që komuna mos t'i kryej obligimet e faturuara me kohë, rrjedhimisht rritjen e obligimeve të papaguara, të cilat do të jenë barrë për buxhetin e vitit vijues.

Rekomandimi A8 Kryetari duhet të sigurojë se respektohen hapat e përcaktuar me rregullat në fuqi për procedimin e pagesave nga zyrtarët përgjegjës, në mënyrë që fillimisht të bëhet zotimi i mjeteve, të nxjerret urdhërblerja dhe më pas pranimi i mallrave/punëve.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.3 Çështjet tjera të menaxhimit financiar dhe të pajtueshmërisë

2.3.1 Të hyrat

Të hyrat e realizuara nga Komuna e Prishtinës në 2023 ishin në vlerë 34,728,204€. Ato kanë të bëjnë me të hyrat nga tatimi në pronë, taksat për leje të ndërtimit, taksat administrative, të hyrat nga veprimtaritë biznesore, të hyrat nga taksat e legalizimit, taksat për mbeturina, të hyrta nga taksat e infrastrukturës.

Çështja B5 - Vonesa në shqyrtimin e kërkesave për dhënien e lejeve të ndërtimit dhe lejeve mjedisore

Gjetja

Sipas Ligjit të Ndërtimit nr.04/L-110, neni 17 pika 1.2, përcakton që “Leja Ndërtimore lëshohet nga organi kompetent Brenda 30 ditëve pas pranimi të kërkesës për leje ndërtimore për kategorinë I dhe 45 ditë për kategoritë II dhe III “. Po ashtu, sipas nenit 11 të UA nr.01-2017 për dhënjen e lejeve mjedisore komunale: Vendimi për miratim ose refuzim të LMK-se i nënshkruar nga Drejtori I Drejtorisë përkatëse, lëshohet në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimi të kërkesës.

Në 12 raste të testuara, kemi vërejtur se komuna nuk kishte respektuar afatet ligjore për shqyrtimin e lejeve të ndërtimit dhe atyre mjedisore. Vonesat e shqyrtimit të lejeve ndërtimore ishin deri në 24 muaj, ndërsa ato të lejeve mjedisore deri në 12 muaj.

Kjo kishte ndodhur si pasojë e mosfunksionimit të mjaftueshëm të kontrolleve për të kryer shqyrtimet e kërkesave në afatet e përcaktuara.

Ndikimi

Shqyrtimi i kërkesave me vonesë ndikon në arkëtimin e vonuar të të hyrave që burojnë nga këto shërbime, si dhe në moskryerjen e shërbimeve me kohë ndaj qytetarëve.

Rekomandimi B5

Kryetari duhet të analizojë shkaqet e vonesave të shqyrtimin e lejeve ndërtimore dhe atyre mjedisore, dhe të marrë masa që ato të shqyrtohen brenda afateve të përcaktuara ligjore.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja C3 - Shfrytëzimi i pronave publike pa kompensim dhe me kontrata të skaduara

Gjetja

Ligji për Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-040, përcakton që komunat kanë të drejtë të japin me qira pasurinë e luajtshme dhe të paluajtshme.

Komisioni i caktuar nga komuna, kishte bërë verifikimin e shfrytëzimit dhe statusit të pronës komunale në zonën industriale ku kishte identifikuar 37 shfrytëzues të cilët shfrytëzojnë 15 parcela të komunës me sipërfaqe prej 9 hektarë, dhe kishte identifikuar gjetjet si në vijim:

- Dy shfrytëzues kanë tejkalluar sipërfaqen e shfrytëzimit të hapësirës komunale që iu është ndarë me vendim, duke e shfrytëzuar atë në mënyrë të paligjshme;
- 16 shfrytëzues me kontrata me afate të skaduara dhe tejkallim të sipërfaqes së shfrytëzimit pa kompensim, duke i shkaktuar humbje

financiare komunës në një periudhe prej 10 vitesh, vlerën prej 366,400€;

- 16 shfrytëzues të pronës pa dokumentacion, duke uzurpuar pronën komunale në sipërfaqe prej 44891m².

Komisioni kishte hartuar raportin me datë 25.04.2023, dhe i njëjti ishte miratuar nga Kuvendi Komunal, ku kishte dhënë rekomandimet në përputhje me gjetjet e identifikuar, për lirim të menjëhershëm të hapësirave të uzurpuara, dhënien në dhënien në shfrytëzim të pronës së komunës në përputhje me ligjet në fuqi për kontratat e skaduara dhe pagesa retroaktive e rentës për tokën e dhënë nga shfrytëzuesit, si dhe lirim të pronës së uzurpuar nga shfrytëzuesit pa dokumentacion. Deri në këtë fazë, lidhur me këto rekomandime, ishte miratuar nga Kuvendi Komunal Rregullorja për dhënie në shfrytëzim të pronës komunale deri në 1 vit, por pas shqyrtimit të ligjshmërisë nga ana e MAPL-së, ajo është kthyer në rishqyrtim. Veprime tjera konkrete në adresimin e këtyre rekomandimeve nuk ishin marrë.

Komisioni i caktuar për verifikimin e shfrytëzimit dhe statusit të banesave në pronë të komunës, me datë 15.04.2023 ka hartuar raportin ku ka bërë verifikimin e 249 njësive banesore dhe ka rekomanduar vazhdimin e kontratave për shfrytëzuesit aktual të cilët i plotësojnë kriteret e përcaktuara në rregullore, ndërsa për pjesën që nuk i plotësojnë kriteret t`u kërkohet liri i pronës komunale në afat prej 30 ditësh. Ky raport me të njëjtat rekomandime ishte miratuar nga Kuvendi Komunal më 15.09.2023, por ende nuk janë ndërmarrë masa për adresimin e rekomandimeve të dhëna.

Këto kishin ndodhur për shkak të mungesës së kontrolleve të mjaftueshme në marrjen e veprimeve nga departamentet përkatëse në adresimin e rekomandimeve të dhëna nga komisionet e caktuara dhe kuvendi komunal.

Ndikimi

Mosmarrja e masave konkrete lidhur me gjetjet e identifikuar dhe rekomandimet e dhëna për t`u kryer në periudha të caktuara kohore nga komisionet përkatëse dhe nga kuvendi komunal, ndikojnë që këto prona të vazhdojnë të keqpërdoren nga shfrytëzuesit dhe komuna të mos inkasojë të hyrat që i takojnë.

Rekomandimi C3

Kryetari duhet të sigurojë që rekomandimet e dhëna nga komisionet përkatëse, të aprovuara nga kuvendi komunal, të zbatohen sipas kërkesave të përcaktuara në afat sa më të shpejtë.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.3.2 Mallrat dhe shërbimet dhe komunalitë

Buxheti final për mallra dhe shërbime ishte 30,058,444€, derisa janë shpenzuar 29,344,957€ apo rreth 97% e buxhetit. Ato kryesisht kanë të bëjnë me shpenzime të projekteve dhe konsulencës, riparimit dhe mirëmbajtjes, blerjen e pajisjeve, shpenzimeve të transportit, etj.

Çështja A9 - Porosia ndaj OE për sigurimin fizik nuk ishte bërë konform dispozitave ligjore dhe aplikim i standardit të dyfishtë me rastin e pagesës

Gjetja

Sipas nenit 54 pika 17 të Rregullores për prokurim publik thekson që kontratat që dalin prej kontratës publike kornizë mund të vazhdojnë përtej afatit të skadimit të kontratës publike kornizë që nënkupton se nëse kontrata ndihmëse ose bërja e urdhrin është dhënë pak kohë para se kontrata publike kornizë të skadojë, dërgesa mund të bëhet pas datës së skadimit.

Tek kontrata publike kornizë "Sigurimi fizik i objekteve dhe institucioneve komunal Lot 1" me vlerë indikativë prej 397,958.88€ (+/- 30%) valide deri më 19.07.2023, kemi vërejtur se komuna kishte bërë pagesë për një muaj në vlerë prej 43,470.46€ jashtë afatit të kontratës. Shërbimet nga OE ishin pranuar edhe pas skadimit të kontratës me urdhrin përmes email-it nga menaxheri i kontratës (datë 11.07.2023), e mbështetur nga interpretimi i zyrës së prokurimit dhe zyrës ligjore. Bërja e urdhrin (porosisë) nuk ishte dëshmuar përmes urdhërblerjes brenda afatit ligjor të kontratës ashtu siç e kërkon rregullorja, pasi që fillimisht është pranuar fatura. Ndërsa, një faturë tjetër si derivat i kësaj kontrate në vlerë prej 24,541€ për shërbime të sigurimit fizik në Drejtorinë e Arsimit nuk është paguar me arsyetimin se janë kryer punimet jashtë afatit të kontratës.

Kjo situatë ishte reflektuar nga disa faktorë, si: inicimi me vonesë i procedurës së prokurimit për të bërë kontraktimin me kohë të sigurimit fizik brenda komunës, porosia e drejtuar operatorit nuk ishte bërë përmes urdhërblerjes dhe nga dështimi i kontrolleve adekuate në lidhje me shpenzimin e parasë publike.

Ndikimi

Mos shpallja me kohë e procedurës së prokurimit për këtë qëllim ka rrezikuar që komuna të mbetet pa shërbime të sigurimit fizik dhe të mos respektohen dispozitat ligjore në lidhje me porositë tek OE duke krijuar mundësinë që të shkaktojë shpenzime më të larta se çmimi aktual përkatës i tregut. Mos respektimi i hapave për procedimin e pagesës mund të shkakton rritjen e obligimeve komunale ndaj operatorëve ekonomik.

Rekomandimi A9

Kryetari duhet të sigurojë forcimin e kontrolleve në Departamentin e Prokurimit dhe Drejtorinë e Financave për t'u siguruar se janë zhvilluar procedurat e prokurimit me kohë për lidhjen e kontratës për shërbimet e sigurimit në mënyrë që shmangen situatat e porosive jashtë afatit të kontratës që bien ndesh me ligjin.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.3.3 Investimet kapitale

Buxheti final për investime kapitale ishte 89,518,394€, prej tyre në 2023 ishin shpenzuar 37,524,476€ apo 42%. Ato kanë të bëjnë me ndërtimin e objekteve arsimore, kulturore, fushave sportive, ndërtimin e rrugëve, mirëmbajtjen investive dhe pagesa nga vendimet gjyqësore.

Çështja A10 - Pagesa për punë të papërfunduara sipas kontratës dhe dëmtimi i punimeve ende pa u përfunduar kontrata

Gjetja

Bazuar në nenin 70.23 të rregullores 001_2022 të prokurimit publik, menaxheri i kontratës do të sigurojë se operatori ekonomik kryen kontratën në përputhje me termat dhe kushtet e specifikuar në kontratë. Poashtu, neni 8.7 i kontratës thekson se kontraktuesi do të siguroj cilësinë e punës dhe për cilësinë e materialeve që janë përdorur për realizimin e punëve të kontraktuara.

Lidhur me kontratën "Renovimi i SHFMU Meto Bajraktari", në vlerë 184,988€, nënshkruar me datë 06.06.2023, ne kemi bërë ekzaminimin fizik të punëve të kryera, me datë 20.03.2024, lidhur me situacionet e paguara deri në fund të vitit 2023, në vlerë 160,112€. Nga ekzaminimi fizik, kemi vërejtur mangësitë si në vijim:

- Tek pozicioni 3 i kontratës që përfshinë "Punet e suvatimit dhe muratimit", ku është paraparë punimi i pozicionit të recepsionit sipas detalit të dhënë nga AK dhe specifikat tjera lidhur me këtë pozicion janë të përshkruara brenda pozicionit, në vlerë 900€, kemi vërejtur se ky pozicion nuk ishte realizuar sipas kontratës, megjithatë ishte pranuar nga menaxheri i kontratës dhe ishte paguar;
- Tek pozicioni 5.1 i kontratës që përfshinë "Furnizimi me material dhe montimi i pllakave të granitit natyral me trashësi 2 cm për ambiente të jashtme" në vlerë 3500€, pllakat e vendosura në shkallët e jashtme të shkollës ishin dëmtuar;
- Tek pozicioni 7 i kontratës që përfshinë "Furnizimi, transporti dhe punimi i dyerve metalike nga çeliku të kualitetit të lartë për përdorim të shpeshtë në të gjitha klasët dhe hapësirat e tjera të shkollës, 50 dyer" një pjesë e këtyre dyerve ishin dëmtuar. Dëmtime poashtu kishin pësuar si pozicionet që kishin të bëjnë me "furnizimin, transportin dhe ngjyrosjen e mureve të brendshme".

Pagesat për punë të papërfunduara kishin ndodhur si pasojë e mosfunksionimit të kontrolleve në menaxhimin e kontratave, ndërsa dëmtimi i furnizimeve dhe punëve të kryera rezultoi më cilësi të dobët të punëve të realizuara. Dëmtimet e mureve të ngjyrosura kishin ndodhur si pasojë e vendosjes së dritareve nga një kontratë tjetër paralele që komuna kishte nënshkruar.

Ndikimi

Pagesa për punë të papërfunduara dhe mos përmirësimi i punëve të dëmtuara, ndikon në shpenzime të paarsyetuara dhe rrezikon mos arritjen e cilësisë dhe objektivave të projektit, duke përfshirë përmirësimin e kushteve të shkollës.

Rekomandimi A10

Kryetari duhet të sigurojë se pozicionet të cilat janë paguar dhe nuk janë përfunduar, të finalizohen në pajtim me kontratën, poashtu të sigurohet se cilësia e punëve të realizuara është në pajtim me kushtet kontraktuale dhe se punët e dëmtuara janë rregulluar në pajtim me kushtet e kontratës.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)**Çështja A11 - Dyfishim i pozicioneve në paramasë në kontratat për të njëjtin projekt**

- Gjetja** Sipas nenit 28 të LPP 2. Autoriteti kontraktues do t'i përpilojë specifikimet teknike në atë mënyrë që ato të jenë në përputhje me qëllimin e prokurimit dhe të drejtuara drejt sigurimit të qasjes sa më të mirë për të gjithë operatorët e interesuar ekonomik dhe tenderuesit. Bazuar po në këtë nen, dhe nenit 10.1 të Rregullorës nr.001_2022, njësia e kërkesës e cila është inicuese e kërkesës për prokurim, ndër të tjera ka përgjegjësi të sigurojë që specifikat teknike për kontratat e punës duhet të përcaktojnë në mënyrë të saktë natyrën dhe karakteristikat e performancës së punëve të kërkuara.
- Lidhur me projektin "Ndërtimi i tribunës lindore të stadiumit 2 korriku" gjatë vitit 2023 ishin lidhur dy kontrata. Kontrata e parë ishte lidhur në mars të vitit 2023, dhe derisa kjo kontratë ishte në fazën e ekzekutimit, ishte lidhur kontrata për fazën e dytë të projektit në nëntor të të njëjtit vit, përmes procedurës së hapur, me po të njëjtin OE. Kontrata e dytë ende nuk kishte filluar ekzekutimin.
- Ne kemi vërejtur se në paramasën e kontratës së dytë, ishin vendosur disa pozicione të njëjta sikurse në paramasën e kontratës së parë por që në kontratën e dytë ishin kontraktuar me çmime më të larta. Këto pozicione të përsëritura ishin tek "Punët e betonit" duke filluar nga pozicioni 3.2 deri tek 3.8 në vlerë 11,015€, si dhe "Punët e muratimit" pozicionet 6.1 dhe 6.2 në vlerë 8,550€. Sasia e këtyre pozicioneve në kontratën e parë ishte në përputhje me planin ekzekutues ndërsa përsëritja e tyre në kontratën e dytë nuk kishte arsyeshmëri nga njësia e kërkesës.
- Kjo kishte ndodhur si rezultat i mungesës së kontrolleve lidhur me vendosjen e specifikave për projekte në procesin e tenderimit.
- Ndikimi** Përsëritja e pozicioneve për punë të njëjta në kontrata të ndryshme, rrezikon pagesën e dyfishtë për punë të njëjta.
- Rekomandimi A11** Kryetari duhet të sigurojë rritjen e përgjegjësisë tek njësitë kërkuese lidhur me përgatitjen e specifikave për kontratat për punë, duke siguruar që ato të jenë në përputhje me projektin ekzekutues, si dhe të ndërmarrë veprime për të parandaluar rreziqet e pagesave të dyfishta për punë të njëjta lidhur me projektet kapitale.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)**Çështja B6 - Vonesat në realizimin e projekteve kapitale**

- Gjetja** Sipas nenit 70.23 të Rregullave 001-2022 për prokurimin publik, menaxheri i kontratës do të sigurojë se Operatori ekonomik kryen kontratën në përputhje me termat dhe kushtet e specifikuar në kontratë. Në kontratat e lidhura ndërmjet komunës dhe operatorëve ekonomik, janë përcaktuar afatet kohore të realizimit të kontratave.
- Poashtu, sipas nenit 29 të Rregullores për prokurim publik, përcaktohet që siguria e ekzekutimit është paraparë të mbështesë përmbushjen e kontratës, ndërsa neni 29.6 thekson se sigurimi i ekzekutimit do të mbetet valid për një periudhë prej tridhjetë (30) ditë pas kompletimit të kontratës.

Ne kemi vërejtur se në kontratat në vazhdim, kishte vonesa në realizimin përtej afatit të përcaktuar të përfundimit të punimeve:

- Kontrata “Ndërtimi i tribunës lindore për stadiumin 2 korriku” në vlerë 108,381€, e nënshkruar me datë 14.03.2023, e cila afatin e realizimit e kishte 90 ditë, në kohën që ne ishim në ekzaminim fizik të këtij projekti në mars të vitit 2024, ky projekt ende nuk kishte përfunduar, dhe punimet ishin ndërprerë pa ndonjë arsytim të vlefshëm;
- Kontrata “Ndërtimi i shkollës së mesme 7 shtatori”, e lidhur me 27.03.2023, afatin e realizimit e kishte 210 ditë kalendarike, ndërkohë që deri në fund të vitit 2023, ishte realizuar vetëm 30% e projektit;
- Kontrata “Ndërtimi I Institucionit Parashkollor Xixellonjat” në vlerë 1,064,197€, e nënshkruar më datë 10.10.2022, e cila afatin e përfundimit e kishte 31.07.2023, ende nuk kishte përfunduar;
- Kontrata “Ndërtimi i rrugës Shkendija në Zllatar” në vlerë 1,233,392€ e nënshkruar më 26.04.2022, e cila afatin e përfundimit të punimeve e kishte 160 ditë kalendarike, ndërsa punimet kishin filluar me 06.07.2022, që nga kjo datë ato do të duhej të përfundonin më 16.12.2022, por që ende nuk kishin përfunduar;
- Marrëveshja për partneritet publiko privat “Ndërtimi i tri shkollave të reja, dhe ofrimi i shërbimit të mirëmbajtjes dhe operimit në ato shkolla”, në vlerë 13,283,386€, e nënshkruar më 31.10.2022, ende nuk kishte filluar punimet;
- Tek kontrata “Master plani për rigjenerimin e lagjes Kodra e Trimave” në vlerë prej 265,600€ e nënshkruar me datë 09.05.2023, me afat të përfundimit prej 6 muajsh, projekti nuk ka përfunduar me kohë dhe nga menaxheri i kontratës nuk është bërë kërkesa për zgjatjen e kohës së implementimit të kontratës. Si rrjedhojë e kësaj, sigurimi i ekzekutimit bankar në vlerë prej 26,560€ kishte skaduar më datë 15.11.2023 dhe Komuna nuk ka kërkuar zgjatje të afatit të garancionit, por pas vërejtjes tonë, është bërë zgjatja e sigurisë së ekzekutimit, më 20.03.2024.

Vonesat në realizimin e projekteve kishin ndodhur si rezultat i ngecjeve të punimeve për shkak të paraqitjes së nevojave për punë shtesë, lidhjes së kontratave pa u pajisur me lejet ndërtimore, vendosja e afateve për realizim të projekteve pa një analizë të duhur, si dhe mospërgjegjësia e operatorëve ekonomik në kryerjen e punimeve sipas afatit të paraparë. Më tutje, mungesa e përgjegjësisë nga menaxheri i kontratës për të kërkuar zgjatjen e afatit të përmbushjes së kontratës dhe afatit të sigurimit të ekzekutimit.

Ndikimi

Vonesat në realizimin e projekteve ndikojnë në mosarritjen e objektivave të komunës, dhe pamundësinë e shfrytëzimit të këtyre projekteve të cilat janë në shërbim të qytetarëve të komunës. Ndërkaq, skadimi i afatit të mbulueshmërisë së sigurimit të ekzekutimit deri në përfundim të projektit rrezikon që komuna të mos ketë mbulesë për dëmet dhe shpenzimet eventuale, dhe pamundëson ndëshkimin eventual ndaj operatorëve në rastet kur kontrata nuk përmbushet.

Rekomandimi B6

Kryetari duhet të sigurojë se para inicimit të projekteve për punë, të përmbushen kushtet e realizimit projektit siç janë, pajisja me lejet e nevojshme për punë, zgjidhja e çështjeve pronësore, hartimi i mirëfilltë i projekteve ekzekutuese për t'u minimizuar kërkesat për punë të pa parapara, si dhe të forcohen kontrollet në mbikëqyrjen e vazhdueshme të progresit të projekteve, në mënyrë që punët të realizohen sipas planeve

dinamike dhe sigurimet e ekzekutimit të ofruara nga operatorët ekonomik të mbulojnë periudhën deri në 30 ditë pas kompletimit të kontratës.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.3.4 Pasuritë kapitale dhe jokapitale

Vlera e paraqitur në PFV e pasurive kapitale është 2,516,375,092€, pasurive jokapitale është 2,831,452€, si dhe e stoqeve 1,109,347€.

Çështja B7 - Mosfunktionalizimi i sistemit e-pasuria dhe moskryerja e inventarizimit në të gjitha drejtoritë

Gjetja

Sipas Rregullores nr.02/2013 për menaxhimin e pasurisë jofinanciare, neni 6, pika 3, pasuritë jokapitale dhe stoqet duhet të regjistrohen dhe menaxhohen nga program e-pasuria. Ndërsa, sipas nenit 18 të kësaj rregulloreje kërkohet që OB duhet të kontrollojnë së paku një herë në vit pasurinë për të vërtetuar dhe vlerësuar gjendjen faktike të pasurisë jofinanciare.

Pasuritë jokapitale dhe stoqet në komunën e Prishtinës, përkundër rekomandimeve të dhëna, ende nuk regjistrohen në programin e-pasuria, por ato regjistrohen në formatin excel.

Komuna kishte bërë inventarizimin e pasurisë në drejtoritë përkatëse, por inventarizimi nuk ishte bërë në drejtorinë e sportit dhe drejtorinë e katastrofit. Poashtu, përveç inventarizimit fizik të pasurive, komisionet përkatëse nuk kishin përgatitur raporte përmbledhëse me të gjeturat rreth inventarizimit.

Kjo kishte ndodhur për shkak të mosveprimeve nga menaxhmenti i komunës lidhur me funksionalizimin e këtij sistemi në komunë. Ndërsa moskryerja e inventarizimit në drejtoritë përkatëse, rezultoi me mungesën e përgjegjësisë në kryerjen e detyrave të përcaktuara nga ZKA.

Ndikimi

Mosfunktionalizimi i sistemit e-pasuria pamundëson menaxhimin dhe kontrollin efektiv të pasurive jokapitale, përderisa mbajtja e evidencave manuale të të dhënave për pasuritë rrezikon në mundësinë e gabimeve në këto regjistra. Moskryerja e inventarizimit në të gjitha drejtoritë si dhe mungesa e një raporti përmbledhës të inventarizimit të pasurive, rezultoi me mangësi të informatave të plota lidhur me pasuritë.

Rekomandimi B7

Kryetari duhet të sigurojë se pasuritë jokapitale dhe stoqet të regjistrohen dhe menaxhohen përmes sistemit e-pasuria. Të ndërmerren veprimet e nevojshme në futjen në përdorim të këtij aplikacioni për menaxhimin e pasurisë. Inventarizimi i pasurisë të kryhet para përfundimit të vitit fiskal, me qëllim që të gjitha ndryshimet në vlerën e pasurisë të reflektojnë në raportin vjetor financiar.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.3.5 Të arkëtueshmet

Komuna e Prishtinës në PFV-të e vitit 2023 ka shpalosur llogari të arkëtueshme në vlerë prej 76,035,612€. Kjo vlerë përbehet nga llogaritë e arkëtueshme nga tatimi në pronë në vlerë 40,288,842€, taksat nga infrastruktura në vlerë 4,309,024€, taksat nga leje ndërtimi në vlerë 12,903,599€, taksat për leje biznesi në vlerë 532,800€ taksat nga mbeturinat në vlerë 12,366,811€, taksat nga qiraja prej 11,171€ dhe lla nga shpronësimet në vlerë 5,623,362€.

Çështja B8 - Mosarkëtimi i borxheve nga tatimi në pronë

Gjetja Ligji për Tatimin në Pronën e Paluajtshme, në nenin 26, përcakton që Ministria e Financave dhe organet kompetente përmbaruese kanë autoritetin dhe kompetencat për të mbledhur detyrimet tatimore që kalojnë shumë 10€, ndërsa në nenin 27 përcaktohet se, nëse një tatimpagues apo debitor nuk ka paguar plotësisht tatimin dhe gjobën në përputhje me afatet e përcaktuara, Komuna nxjerr njoftimin përfundimtar me shkrim brenda 10 ditëve pune pas ditës së fundit për pagesë, ku kërkon pagesën e plotë të detyrimeve tatimore të papaguara, jo më vonë se 10 ditë kalendarike pas ditës që njoftimi përfundimtar konsiderohet të jetë pranuar nga debitori.

Llogaritë e arkëtueshme për vitin 2023 ishin gjithsej 76,035,612€, prej të cilave 40,288,843€ apo 53% ishin për tatimin në pronë. Komuna kishte dërguar një listë për kërkesë të inicimit të procedurës përmbarimore, ndaj disa debitorëve për përmbarimin e detyrimeve të papaguara të tatimit në pronë në dhjetor të vitit 2022, megjithatë nuk kishte pasur asnjë rezultat në arkëtimin e këtyre borxheve. Më tutje komuna nuk kishte marrë veprime tjera lidhur me arkëtimin e borxheve.

Kjo kishte ndodhur si rezultat i mungesës së veprimeve të vazhdueshme të departamenteve përgjegjëse në tentim të mbledhjes së të arkëtueshmeve.

Ndikimi Mosinkasimi i të arkëtueshmeve reflekton në shkallë më të ulët të buxhetit nga të hyrat vetanake. Rrjedhimisht, kjo mund të ndikojë edhe në arritjen e objektivave të Komunës, duke pamundësuar investime në projekte që financohen nga këto fonde.

Rekomandimi B8 Kryetari duhet të sigurojë forcimin e mekanizmave të kontrollit në mbledhjen e borxheve nga tatimpaguesit, duke i shfrytëzuar të gjitha mjetet në dispozicion, pa përjashtuar edhe veprimet ligjore.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

3 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit

Në këtë kapitull kemi prezantuar një informacion të përmbledhur për burimet e fondeve buxhetore, shpenzimin e fondeve dhe të hyrave të mbledhura, sipas kategorive ekonomike. Kjo është ilustruar përmes tabelave dhe grafikëve të mëposhtëm:

Tabela 1. Shpenzimet sipas burimeve të fondeve buxhetore (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final ⁷	2023 Shpenzimet	2022 Shpenzimet	2021 Shpenzimet
Burimet e fondeve	109,388,981	167,416,325	114,195,436	87,375,438	80,290,988
Grante Qeveritare - Buxheti	72,222,118	78,764,844	70,033,925	58,872,924	51,494,467
Financimi përmes huamarrjes	0	0	0	624,289	857,737
Financimi përmes huamarrjes - klauzola e investimeve	3,000,000	3,000,000	0	0	0
Të bartura nga viti i kaluar	0	51,425,219	25,056,184	16,043,271	17,139,524
Të hyrat vetanake	34,166,863	34,166,863	19,105,328	11,831,886	10,729,366
Donacionet vendore	0	34,554	0	1,500	0
Donacionet e jashtme	0	24,845	0	1,567	69,893

Buxheti fillestar i Komunës së Prishtinës është më i lartë se buxheti fillestar për 58,027,325€. Kjo rritje e buxhetit është rezultat i vendimeve të Qeverisë për ndarje buxhetore në vlerë prej 6,542,726€, përfshirjes së të hyrave të bartura prej 51,425,218€ dhe donacioneve në vlerë prej 59,399€ në buxhet final.

Në vitin 2023, Komuna ka shpenzuar 68.2% të buxhetit final ose 114,195,436€, me një rritje prej 4% në raport me vitin e kaluar. Sidoqoftë, shpjegimet për pozicionin aktual janë detajuar më poshtë.


Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final	2023 Shpenzimet	2022 Shpenzimet	2021 Shpenzimet
Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike	109,388,981	167,416,325	114,195,436	87,375,438	80,290,988
Pagat dhe mëditjet	32,935,000	39,582,573	39,574,435	32,700,638	31,448,161
Mallrat dhe shërbimet	25,150,000	30,058,444	29,344,958	26,396,100	19,474,911
Komunalitë	2,748,000	2,823,006	2,607,669	2,517,257	1,987,860
Subvencionet dhe transferet	5,150,000	5,433,908	5,143,898	7,396,124	9,969,735
Investimet Kapitale	43,405,981	89,518,394	37,524,476	18,365,319	17,410,321

Sqarimet rreth ndryshimeve buxhetore janë shpalosur si në vijim:

- Buxheti final për paga dhe mëditje në krahasim me buxhetin fillestar ishte rritur për 6,647,574€. Buxheti final përbëhet nga granti qeveritar në vlerë prej 39,477,726€, pastaj nga të hyrat vetanake të bartura prej 100,000€ dhe donacionet e jashtme prej 4,847€. Realizimi i shpenzimeve deri në fund të vitit ishte 99.9%;
- Buxheti final për mallra dhe shërbime në krahasim me buxhetin fillestar ishte rritur për 4,908,444€. Pjesa më e madhe e këtij buxheti përbëhet nga granti qeveritar prej 19,812,000€, të hyrave vetanake prej 5,338,000€, të hyrave të bartura prej 4,904,994€ dhe donacionet në vlerë prej 3,450€. Deri në fund të vitit, realizimi i buxhetit ishte 97.6%;
- Buxheti final për shpenzime komunale në krahasim me buxhetin fillestar kishte rritje për 75,006€. Ky buxhet përbëhet nga 2,748,000€ dhe të hyrat vetanake të bartura prej 75,006€, dhe realizimi i buxhetit ishte 92.3%;
- Buxheti final për subvencione dhe transfere në krahasim me buxhetin fillestar kishte rritje për 283,908€. Ky buxhet përbëhet nga fondi qeveritar prej 3,150,000€, të hyrave vetanake prej 2,000,000€, të hyrave vetanake për bartje prej 250,000€ dhe grantit të donacioneve të brendshme prej 33,908€. Realizimi i buxhetit në fund të vitit ishte 94.6%;
- Buxheti final për investime kapitale në krahasim me buxhetin fillestar kishte rritje në vlerë prej 46,112,413€. Ky buxhet përbëhet nga fondi i huamarrjes në vlerë prej 3,000,000€, fondi qeveritar prej 13,577,118€, të hyrave vetanake prej 26,828,863€, të hyrave vetanake për bartje prej 46,095,218 dhe donacioneve prej 17,194€. Deri në fund të vitit Komuna kishte arritur të shpenzoj vetëm 37,524,476€ apo 41.9%. Ky nënrealizim i buxhetit fillimisht vinte si pasojë e mos realizimit të projekteve ekzistuese si rezultat i ndërprerjes së kontratave të nënshkruara para vitit 2022 për shkak të inflacionit dhe kërkesës për rishikim të çmimeve nga operatorët ekonomik. Më tutje edhe pse shumë nga këto kontrata ishin ritenderuar dhe nënshkruar gjatë vitit 2023, ato kishin hasur pengesa në realizim qysh në fillim për shkak të mos plotësimit të kushteve për fillim të punimeve, sikurse mos pajisja me leje të nevojshme, problemet me shpronësimet, punë të paplanifikuara si rezultat i mos hartimit të mirë të projekteve, si dhe mos përgjegjësia e operatorëve ekonomik për të kryer punimet sipas planit dinamik.

Grafiku 1. Shpenzimet sipas kategorive ekonomike për vitin 2023



Të hyrat e realizuara nga Komuna e Prishtinës në 2023 ishin në vlerë 34,728,204€. Ato kanë të bëjnë me të hyrat nga tatimi në pronë, taksat për leje të ndërtimit, taksat administrative, të hyrat nga veprimtaritë biznesore, të hyrat nga taksat e legalizimit, taksat për mbeturina, të hyra nga taksat e infrastrukturës. Për vitin 2023, Komuna kishte planifikuar të hyra në vlerë prej 34,166,863€, ku tejkalim i planit ishte 1,082,151€. Në krahasim me vitin e kaluar niveli i inkasimit të të hyrave ka rritje prej 3,152,048€. Rritja kryesisht ka të bëjë me tatimin në pronë.

Përveç kësaj shume, të hyrat nga gjobat në trafik dhe gjobat nga Gjykatat ishin në shumën prej 2,781,338€ të cilat grumbullohen nga Ministria e Punëve të Brendshme (MPB) dhe Këshilli Gjyqësor i Kosovës (KGJK) të cilat i alokohen Komunës për shpenzim. Këto të hyra nuk janë të përfshira në tabelën e më poshtme, për arsye se këto i planifikojnë dhe realizojnë ministrinë e linjës.

Tabela 3. Të hyrat (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final	2023 Pranimet	2022 Pranimet	2021 Pranimet
Totali i të hyrave	34,166,863	34,166,863	34,728,204	31,576,156	35,436,252
Të hyrat tatimore	11,366,219	11,366,219	13,133,087	9,161,332	10,659,137
Të hyrat jo tatimore	22,800,644	22,800,644	21,587,700	22,396,975	24,769,464
Të hyrat tjera	0	0	7,417	17,848	7,651

4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Raporti i auditimit për PFV-të të vitit 2022 të Komunës së Prishtinës ka rezultuar në 22 rekomandime kryesore. Komuna kishte përgatitur një Plan Veprimi ku paraqitet mënyra se si do t'i zbatohet rekomandimet e dhëna.

Deri në fund të auditimit tonë për vitin 2023, 11 rekomandime janë zbatuar; tri (3) ishin në proces dhe tetë (8) nuk ka filluar zbatimin ende, siç është paraqitur në Grafikonin 2, më poshtë.

Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrën se si janë trajtuar ato, shihni në Tabelën 3 (ose Tabelën e rekomandimeve).

Grafiku 2. Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak




Tabela 4 Përmbledhja e rekomandimeve të vitit paraprak

Nr	Fusha e Auditimit	Rekomandimet e vitit 2022	Veprimet e ndërmarra	Statusi
1.	Baza për opinion	Kryetari duhet të sigurojë se buxheti vjetor planifikohet në kategoritë përkatëse ekonomike, më tutje të sigurohet se të gjitha shpenzimet janë klasifikuar në mënyrë të saktë dhe të drejtë në raportimet financiare.	Nuk janë ndërmarrë veprime për të klasifikuar drejtë shpenzimet nga kodet jo adekuate.	Nuk ka filluar zbatimin
2.	Baza për konkluzion	Kryetari duhet të sigurojë se kontratat lidhen në kohën e duhur, faturimi dhe pranimi i punëve si dhe pagesa për këto bëhen sipas çmimeve të kontraktuara për periudhën përkatëse dhe jo në mënyrë retroaktive.	Rekomandimi nuk është zbatuar, pasi që edhe këtë vit Komuna kishte lidhur kontrate për shërbime retroaktive.	Nuk ka filluar zbatimin

3.	Baza për konkluzion	Kryetari duhet të sigurojë, aplikimin e procedurave të hapura të prokurimit duke rritur konkurrencën, në mënyrë që kontraktimi i mallrave/ shërbimeve të bëhet me çmime dhe cilësi sipas kushteve të tregut.	Nga mostrat e testuara në fushën e prokurimit nuk kemi hasur në raste ku janë aplikuar procedura jo adekuate të prokurimit.	I zbatuar
4.	Baza për konkluzion	Kryetari duhet të sigurojë që, shpenzimi i parasë publike të jetë në përputhje me ligjin për ndarjet buxhetore të vitit përkatës.	Komuna kishte ndërmarrë veprime për implementimin e këtij rekomandimi dhe nga mostrat e testuara këtë vit nuk kemi hasur në pagesa për pako ushqimore për zyrtarët e Komunës së Prishtinës.	I zbatuar
5.	Baza për konkluzion	Kryetari duhet të sigurojë që, para investimeve në projektet e teknologjisë së informacionit të marrë pëlqimin nga Agjencia e Shoqërisë së Informacionit. Po ashtu, të shtojë kontrollet e brendshme lidhur me menaxhimin e projektit në vazhdimësi.	Nga mostrat e testuara këtë vit nuk kemi hasur në projekte të fushës së teknologjisë informative që janë kontraktuar nga Komuna e që nuk kishin marrë pëlqim nga ASHI për iniciimin e projektit.	I zbatuar
6.	Pasqyrat Financiare Vjetore	Kryetari duhet të sigurojë se, shpalosjet e llogarive të arkëtueshme në pasqyrat vjetore financiare të jenë të plota dhe të sakta.	Janë marrë veprime në adresimin e rekomandimit.	I zbatuar
7.	Të hyrat	Kryetari të sigurojë bashkëpunim dhe komunikim më të mirë ndërmjet Departamentit të Tatimit në Pronë Komunal dhe Ministrisë së Financave, në mënyrë që të eliminohen gabimet e mundshme në të dhënat për tatimin e vlerësuar, apo ndonjë gabim tjetër eventual.	Për gjetjet e vitit të kaluar janë bërë përmirësimet mirëpo sërish janë evidentuar mangësitë në aplikimin e zbritjeve për vendbanimet parësore.	Pjesërisht i zbatuar
8.	Të hyrat	Kryetari duhet sigurojë se kërkesat për leje ndërtimore dhe mjedisit të shqyrtohen brenda afateve të përcaktuara ligjore. Të analizohen rastet e mungesave të kapaciteteve njerëzore dhe të shqyrtohen mundësit për zgjidhjen e kësaj çështje.	Nuk janë ndërmarrë veprime në këtë drejtim.	Nuk ka filluar zbatim

9.	Të hyrat	Kryetari duhet ti përmbahet zotimeve sipas planit të veprimit të përgatitur nga vet komuna që çështja e këtyre pronave të zgjidhet duke përdor të gjitha mundësit ligjore. Të siguroj se pronat komunale shfrytëzohen vetëm përmes kontratave valide, dhe marrjen e veprimeve konkrete në inkasimin e të hyrave.	Jane marrë pjesërisht veprime, ku nga komisionet janë identifikuar gjetjet dhe janë dhënë rekomandimet përkatëse por ende nuk ka veprime konkrete në adresimin e tyre.	Pjesërisht i zbatuar
10.	Pagat dhe mëditjet	Kryetari duhet të sigurojë se angazhimi i punonjësve përmes kontratave për punë dhe detyra specifike të aplikohet vetëm në rastet për punë dhe detyra që kanë natyrë të veçantë, e jo për pozita të rregullta të punës. Afati kohor i llojit të tillë të kontratave të mos tejkalojë 120 ditë brenda një viti.	Komuna kishte ndërmarrë veprime për implementimin e këtij rekomandimi dhe nga 183 punonjës të angazhuar për detyra dhe punë specifike në fund të vitit kontratat nuk iu janë vazhduar.	I zbatuar
11.	Pagat dhe mëditjet	Kryetari duhet të sigurojë që, pozitat e punës të mbajtura me ushtrues të detyrës, të plotësohen me punonjës me kontrata të rregullta të punës.	Komuna gjate vitit 2023 kishte ndermarre veprime per te implementuar kete rekomandim.	I zbatuar
12.	Pagat dhe mëditjet	Kryetari duhet të sigurojë se përzgjedhja e kandidatëve të bëhet në mënyrë transparente, konkurruese dhe në bazë të meritës. Komisionet e vlerësimit të jenë në përbërje sipas kriterëve të përcaktuara, dhe që me rastin e vlerësimit të zbatojnë kushtet dhe kriteret e përcaktuara me konkurs.	Nga testimi i mostrave për procedura te rekrutimit këtë vit nuk kemi hasur në raste të tilla.	I zbatuar
13.	Pagat dhe mëditjet	Kryetari duhet të sigurojë se, punët shtesë realizohen vetëm nëse parapakisht janë arsyetuar dhe autorizuar orët e punëve shtesë nga mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë, dhe se mbahet evidencë për orët dhe ditët e angazhimeve në punët shtesë.	Komuna gjatë vitit 2023 kishte ndërmarrë veprime për të implementuar rekomandimin duke u përmbajtur kërkesave ligjore për realizimin e punëve dhe orëve shtesë.	I zbatuar
14.	Subvencionet dhe transferet	Kryetari duhet të sigurojë se me rastin e subvencionimit të OJQ-ve, respektohen kërkesat e Rregullores, ashtu që mbështetja financiare të bëhet me thirrje publike sipas kriterëve të përcaktuara. Po ashtu, të kërkohen raporte kthyesë financiare dhe narrative nga përfituesit.	Komuna edhe këtë vit kishte ndarë subvencione ndaj OJQ-ve pa aplikuar thirrjen publike.	Nuk ka filluar zbatim

15.	Subvencionet dhe transferet	Kryetari duhet të sigurojë se do ketë ndarje të duhur të detyrave me rastin e procesit të vlerësimit për subvencionimin e fermerëve. Zyrtarët që kanë përgatitur specifikimet dhe/ose termat e referencave të mos janë pjesë e komisionit në vlerësimin e përfituesve dhe të menaxhojnë mbikëqyrjen e kontratës duke shmangur çfarëdo konflikti të mundshëm.	Nuk kemi hasur në raste të tilla gjatë vitit 2023.	I zbatuar
16.	Investimet kapitale	Kryetari duhet të sigurojë që kontratat publike kornizë zbatohen sipas kushteve dhe çmimeve kontraktuale. Në rastet kur paraqiten nevojat për amendamentim të kontratës publike, ajo të bëhet në përputhje me kërkesat ligjore, rregullën dhe udhëzuesin për prokurimin publik, duke mos tejkaluar pragun e lejuar prej 30%.	Janë hasur sërish raste të tejkalimit të sasive në kontratat publike kornizë me çmime për njësi.	Pjesërisht i zbatuar
17.	Investimet kapitale	Kryetari duhet të sigurojë përmes njësive kërkuese dhe zyrës së prokurimit se, paramasa dhe paralogaria përcaktojnë në mënyrë të saktë natyrën dhe karakteristikat e performancës të punëve të kërkuara, të përgatiten në pajtueshmëri të plotë me kërkesat sipas projektit/ Derisa, në raste kur kërkohet, problemet pronësore dhe lejet e nevojshme për punimet që do të ekzekutohen, të zgjidhen para nënshkrimit të kontratave.	Nuk janë ndërmarrë veprime për të siguruar realizimin e projekteve kapitale sipas planit dinamik.	Nuk ka filluar zbatimin
18.	Çështjet e përbashkëta	Kryetari duhet të sigurojë se menaxherët e kontratave monitorojnë dhe sigurojnë se kontratat publike për punë, furnizime dhe shërbime, realizohen sipas kushteve kontraktuale përfshirë edhe pagesat përkatëse.	Edhe këto vit janë hasur pagesa për vendime gjyqësore dhe vonesa në kryerjen e obligimeve.	Nuk ka filluar zbatimin
19.	Pasuritë	Kryetari duhet të sigurojë se pasuritë jokapitale dhe stoqet të regjistrohen dhe menaxhohen përmes sistemit e-pasuria. Të ndërmerren veprimet e nevojshme në futjen në përdorim të këtij aplikacioni për menaxhimin e pasurisë. Inventarizimi i pasurisë të kryhet para përfundimit të vitit fiskal, me qëllim që të gjitha ndryshimet në vlerën e pasurisë të reflektojnë në raportin vjetor financiar.	Rekomandimi nuk është zbatuar pasi e-pasuria ende nuk është funksionalizuar brenda komunës. Poashtu nuk është kryer inventarizimi në të gjitha drejtoritë, dhe komisioni i inventarizimit nuk ka hartuar raport përmbledhës për procesin e inventarizimit.	Nuk ka filluar zbatimin

20.	Llogaritë e arkëtueshme	Kryetari duhet të sigurojë forcimin e mekanizmave të kontrollit në mbledhjen e borxheve nga tatimpaguesit, duke i shfrytëzuar të gjitha mjetet në dispozicion, pa përjashtuar edhe veprimet ligjore.	Rekomandimi nuk është zbatuar pasi nuk janë marrë masa efektive për arkëtimin e borxheve nga tatimpaguesit.	Nuk ka filluar zbatimin
21.	Detyrimet Kontigjente	Kryetari duhet të sigurojë, se detyrimet kontigjente të shpalosura në raportin vjetor financiar, duhet të jenë të plota, pavarësisht se në cilën fazë të shqyrtimit nga autoritetet përkatëse janë ato, deri në marrjen e një vendimi final nga organet kompetente.	Janë marrë veprime për mos dyfishimin e detyrimeve kontigjente.	I zbatuar
22.	Auditimi i Brendshëm	Kryetari duhet të sigurojë se, drejtoritë e audituara përgatitin planet e veprimit për adresimin e rekomandimeve të NjAB-së, dhe ndërmarrin veprime konkrete për zbatimin e rekomandimeve të dhëna në raportet e auditimit të brendshëm.	Rekomandimi ishte zbatuar pasi që të gjitha drejtoritë kanë përgatitur plane të veprimit për implementimin e rekomandimeve të dhëna nga NjAB	I zbatuar

Vlora Spanca, Auditore e Përgjithshme



Agron Fetiu, Ndhmës Auditor i Përgjithshëm



Blerim Kabashi, Drejtor i Auditimit



Erëmira Bytyqi - Pllana, Udhëheqëse e ekipit



Nora Rashiti Nishefci, Anëtare e ekipit



Kushtrim Leci, Anëtar i ekipit



Shtojca I: Letër konfirmimi

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO			
ZYRA KOMBËTARE E AUDITIMIT			
NACIONALNA KANCELARIJA REVIZIJE / NATIONAL AUDIT OFFICE			
DATE E PRANIMIT NE ZYRËN E BASHKËPUNËSIAVE / DATE OF RECEIPT IN THE JOINT OFFICE: 19.06.2024			
SHTIMET E PËRMBAJTJES / ADDITIONAL INFORMATION:			
Nr. Detyr. Org. Unit	Sh. Klasif. Class. Code	Nr. Prot. Br. Prot. Prot. No.	Nr. i Efaqeve Ek. Stranica No. Pages
04	47	875	1



Republika e Kosovës
 Republika Kosova – Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës
 Opština Prishtina – Municipality of Prishtina



LETËR E KONFIRMIMIT

Për pajtueshmërinë me gjetjet e Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2023 dhe për zbatimin e rekomandimeve

Për: Zyrën e Kombëtare të Auditimit

Të nderuar,

Përmes kësaj shkrese, konfirmoj se:

- kam pranuar draft raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit për auditimin e Pasqyrave Financiare të Komunës së Prishtinës, për vitin 2023 (në tekstin e mëtejshëm “Raporti”);
- pajtohem me gjetjet dhe rekomandimet dhe nuk kam ndonjë koment për përmbajtjen e Raportit; si dhe
- brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t’ju dorëzoj një plan të veprimit për zbatimin e rekomandimeve, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për zbatimin e tyre.

Z. Përparim Rama

Kryetar i Kryeqytetit

ata: 13.06.2024, Prishtinë,



Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinionëve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

Raporti i auditorit për pasqyrat financiare⁸ duhet të përmbajë një opinion për pasqyrat financiare, bazuar në përfundimet e nxjerra nga dëshmitë e marra gjatë auditimit. Kur auditimi kryhet për të vlerësuar gjithashtu përputhjen me legjislacionin dhe rregulloret e tjera, auditorët kanë një përgjegjësi shtesë për të raportuar për pajtueshmërinë me autoritetet⁹, duke rezultuar me konkluzion mbi pajtueshmërinë.

Për të arritur në përfundimin se një opinion mbi pasqyrat financiare është i modifikuar ose i pa modifikuar, një auditor duhet të sigurohet që rezultatet e auditimit përfshijnë, apo jo, keq-deklarim (e) material(e) ose të përhapur(a), apo të tillë(a) të mundshëm(me), të supozuar në rast kufizimi të fushëveprimit.

Keq-deklarimi është një ndryshim mes shumës së raportuar, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit të një zëri të pasqyrës financiare dhe sasisë, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit që kërkohet që zëri të jetë në përputhje me kornizën e raportimit financiar në fuqi. Keq-deklarimet mund të vijnë nga gabimi ose mashtrimi.

(shkëputur nga SNISA 200)

Forma e opinionit

Opinion i pa-modifikuar

Formulohet kur nuk janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri; kur janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, por që nuk është i barabartë me ose nuk e tejkalon nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi(et) dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh nuk është e barabartë me ose e tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse nuk ka kufizim të fushëveprimit ose kur kufizimi i fushëveprimit nuk mund të shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e) dhe/ose mos-pajtueshmërisë(ve).

Kufizimi i fushëveprimit ndodh kur një auditor nuk është në gjendje të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale.

Auditori duhet të japë **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Modifikimi i opinionit në raportin e auditorit

Auditori duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit nëse konstatohet se, bazuar në dëshmitë e marra nga auditimi, pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri, ose nuk është në gjendje të sigurojë prova të mjaftueshme të auditimit për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri..

Opinionit i modifikuar mund të jetë:

- I kualifikuar,
- I kundërt, ose
- Mohim opinionit

Opinionit i kualifikuar

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që janë të barabartë me ose e tejkalojnë nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh është i barabartë me ose tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse ka kufizim të fushëveprimit, i cili mund të mos shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e).

Opinionit i kundërt

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që tejkalon në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimet dhe/ose mos-pajtueshmëritë e zbuluara brenda një klase të caktuar transaksionesh e tejkalojnë në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve.

“E përhapur” është term që përdoret, në kontekstin e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërive, për të përshkruar efektet e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë në pasqyrat financiare; ose efektet e mundshme në pasqyrat financiare të keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë, nëse ka të tilla, që nuk zbulohen për shkak të pamundësisë për të marrë dëshmi të mjaftueshme e të duhura të auditimit. Efektet e përhapura në pasqyrat financiare janë ato që, sipas gjykimit të auditorit::

- a) Nuk kufizohen vetëm në elemente, llogari ose zëra të veçantë të pasqyrave financiare;
- b) Por nëse kufizohen si të tilla, përfaqësojnë ose mund të përfaqësojnë një pjesë të konsiderueshme të pasqyrave financiare; ose
- c) Për sa i përket shpalosjeve, janë thelbësore që përdoruesit të kuptojnë pasqyrat financiare.

Mohim i opinionit

Formulohet kur kufizimi i fushëveprimit, d.m.th. kur pamundësia për të siguruar prova të mjaftueshme të përshtatshme të auditimit, është i natyrës materiale dhe pervazive.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të tërheqë vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka dëshmi të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keq-deklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë paragrafin e Theksimit të çështjes në raportin e tij. Paragrafi për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohet vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

Paragrafi i theksimit të çështjes duhet:

- të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- të ketë titullin 'theksim i çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç'pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen; dhe
- të tregojë se opinionin e auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të komunikojë një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që të kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje të tjetra", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të çështjes.

Shënime fundore

- ¹ Pajtueshmëria me autoritetet - pajtueshmëria me të gjitha ligjet, rregullat, rregulloret, standardet dhe praktikat e mira relevante në sektorin publik
- ² Raportet tjera janë kërkesë e nenit 8 të së Rregullores 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar
- ³ Kolektivisht të referuara si pajtueshmëri me autoritetet
- ⁴ Çështja A dhe Rekomandimi A - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e reja
Çështja B dhe Rekomandimi B - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e përsëritura
Çështja C dhe Rekomandimi C- nënkupton çështjet dhe rekomandimet pjesërisht të përsëritura.
- ⁵ Fatura në vlerë prej 24,541€ e pranuar më datë 31.08.2023 dhe fatura në vlerë prej 2,418€ e pranuar më datë 08.12.2023.
- ⁶ - Per kontraten "Furnizim me agregata per shkolla" fatura ne vlere 349,890Eur, mjetet jane marre nga kater projekte kapitale si: 74,890€ nga kodi 50971 (Ndertimi i ankesit te shkolles Pavaresia); 75,000€ nga kodi 52657 - (Ndertimi i shkolles ne lagjen Kalabria); si dhe vlere prej 100,000€ nga kodi 53600 (Renovimi i shkollave fillore : Asim Vokshi,Zenel Hajdini,Nazim Gafurri,Nexhmi Mustafa,Isa Boletini,Ditura); si dhe 100,000€ nga kodi 53602 (Blerja e paisjeve per bibliotekat shkollore ne Ismail Qemali, Hasan Prishtina,Gjergj Fishta,Meto Bajraktari,Asim Voksh,Model); - Per kontraten "Plani i mobilitetit per shenjezimin e shtegut te bicikletave" pagesa ne vlere 372,339Eur, mjetet jane marre me aprovim te ZKA-se nga kodi 51052 "Rruga A kolektori dhe rruga"; - Per kontraten "Ndertimi i rruges Stallove" Zllash, pagesa ne vlere 218,000Eur, mjetet jane marre me aprovim te ZKA-se nga kodi 51052 "Rruga A kolektori dhe rruga"; - Per kontraten "Ndertimi i rruges Brahim Beka" pagesa ne vlere 102,000, mjetet jane marre me aprovim te ZKA-se nga projekti me kod 48038 "Vazhdimi i rruges B"; - Per kontraten "Ndertimi i zhveshtoreve ne tribunen Flamurtari", 65000 mjetet jane marre me aprovim te ZKA-se nga projekti "Ndertimi I salles multifunksionale ne Komunen e Prishtines Kodi" 49784; - Per kontraten "Sherbime urgjente te mirembajtjes dhe riparimeve ne hapesirat publike" me NPB pagesat ne vlere 296,953Eur; 151,271.15Eur dhe 169.793,02, mjetet jane marre nga projekti me kodin 52653 ne ligjin e buxhetit " Ndertimi i rrugeve -Rr. Bashkim Fehmiu, Rr. Mine Pezai,Rr. Papa Gjon Pali, Rr. Shahin Kolonja"; - Per kontraten "Mirembajtja e rregullt dhe renovimi urgjent I ndertesave edukativo arsimore ne Komunen e Prishtines" me NPB, pagesat ne vlere 186.587,07Eur; 219,571.85Eur, mjetet jane marre nga kodi i projektit 53600 " Renovimi i shkollave fillore : Asim Vokshi,Zenel Hajdini,Nazim Gafurri,Nexhmi Mustafa,Isa Boletini,Ditura"; - Per kontraten "Furnizim me libra per biblioteka" pagesa ne vlere 42,766.38Eur, mjetet jane marre nga projekti kapital me kod 53602" Blerja e paisjeve per bibliotekat shkollore ne Ismail Qemali, Hasan Prishtina,Gjergj Fishta,Meto Bajraktar,Asim Voksh,Model" - Per kontraten "Mirembajtja e ashensoreve per objektet e banesave kolektive", pagesa ne vlere 35,411Eur, mjetet jane marre nga projekti me kodin 53589 "Ndertimi dhe rekonstruimi i pritoreve te autobusave, bankave per pushimore:Qendra,Tophane,Dodona,Bregu i Diellit,Ulpiana, Dardania, Lakrishte Kodra e Trimave, Bernice, Kolovice, Velania".
- ⁷ Buxheti Final - buxheti i aprovuar nga Kuvendi i përshtatur më pas nga Ministria e Financave
- ⁸ Pasqyrat financiare në sektorin publik përfshijnë po ashtu edhe pasqyrën(at) e ekzekutimit të buxhetit
- ⁹ Pajtueshmëria me autoritetet: pajtueshmëria me ligjet, rregulloret, standardet, apo praktikat e mira.